

Q. 76
03.02.09



KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Tiranë më 03.02.2009

Nr. 76 Prot.

Lenda: Dërgohet Raporti i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2008

Për: Zonjën Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuara zonja Kryetare

Në zbatim të ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", si edhe shkresës Tuaj nr. 216 prot. Dt. 19.01.2009, bashkëlidhur po ju sjellim Raportin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për punën e bërë gjatë vitit 2008 të printuar dhe me cd.

MESILA DODA (DEMI)
KRYETARE

Mesila Doda
03.02.09

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VEPRIMTARINË E ZHVILLUAR GJATË VITIT 2008

1. STRATEGJIA E KALIMIT NGA SISTEMI ANALOG NË ATË NUMERIK

2. KUADRI LIGJOR, RREGULLIMI DHE MBIKQYRJA E VEPRIMTARISË RADIO TELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE

- 2.1 Legjislacioni dhe ndryshime
- 2.2 Licencimet
- 2.3 Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së
- 2.4 Raportimi i ndryshimeve nga operatorët
- 2.5 Respektimi i së drejtës së transmetimit dhe të drejtave të autorit
- 2.6 Çështjet gjyqësore

3. PROGRAMACIONI

- 3.1 Situata dhe dukuri programore në media
- 3.2 Mbi etikën në media
- 3.3 Programet në Radiotelevizionin Publik Shqiptar.
- 3.4 Monitorimi
 - 3.4.1 Monitorimi i emisioneve informative
 - 3.4.2 Dukuri të veçanta
 - 3.4.3 Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet
 - 3.4.4 Raportet kohore për gjininë
 - 3.4.5 Raportet kohore për temën e lajmit
 - 3.4.6 Mangësi të bazës ligjore
 - 3.4.7 Monitorimi i reklamave
 - 3.4.8 Ngjarje të ndodhura

4. RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

- 4.1 Planifikimi i rrjeteve numerike
 - 4.1.1 Klasifikimi i operatorëve të rrjeteve numerike
 - 4.1.1.1 Njësitë e licencimit që mund të krijohen për DVB-T
 - 4.1.1.1.2 Njësitë e licencimit që mund të krijohen për T- DAB
 - 4.1.1.1.2 Operatorët kombëtarë
 - 4.1.1.1.2.1 Rrjete të operatorit publik Televizioni publik
 - 4.1.1.1.2.2 Rrjete të operatorëve privatë Operatorët kombëtarë
 - 4.1.1.1.2.3 Operatorët rajonale
 - 4.1.1.1.2.4 Operatorët lokalë
 - 4.1.1.1.3 Tabela përmbledhëse e klasifikimit të operatorëve
- 4.2 Përgatitja e dokumentacionit teknik për licencimin e rrjeteve numerike

- 4.2.1 Hartimi i planit të Caktimeve Frekuencore (Konvertimi i allotmenteve në Caktime)
- 4.2.2 Miratimi i kushteve teknike të rrjeteve numerike dhe kushtet e tjera për Operatorët e Rrjeteve Numerike Tokësore
- 4.2.3 Vendime të karakterit strategjik e rregullator

- 4.3 puna për fillimin e vënies në jetë të planit numerik
- 4.3.1 Lirimi i frekuencave të zëna nga transmetimet analoge

- 4.4 Dividendi Numerik

- 4.5 Monitorimi

- 4.6 Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.
- 4.6.1 Televizioni publik
- 4.6.1.1 Programet
- 4.6.1.2 Transmetim
- 4.6.1.3 Studiot
- 4.6.1.4 Struktura e organizimit të RTSH-së
- 4.6.1.5 Financimi i RTSH-së
- 4.6.1.6 Numerizimi i RTSH-së

- 4.6.2 Operatorët privatë kombëtarë
- 4.6.2.1 Operatori Kombëtar TVA
- 4.6.2.2 Operatori Kombëtar TV KLAN
- 4.6.2.3 Operatori Kombëtar TV TOP CHANNEL
- 4.6.3 Operatorët privatë vendorë
- 4.7 Transmetimet numerike ekzistues

5. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN

- 5.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative
- 5.2 Struktura e Drejtorisë Teknike
- 5.3 Marrëdhëniet me jashtë
- 5.4 Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit

6. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË

- 6.1 Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve
- 6.2 Bilancet kontabël të operatorëve RTV

7. KONKLUSIONE

8. ANEKS (Tabela Financiare)

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT PËR VEPRIMTARINË E ZHVILLUAR GJATË VITIT 2008

KKRT, në përputhje me ligjin organik nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, raporton çdo vit përpara Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e kryer prej saj dhe për mënyrën se si janë respektuar nga subjektet radiotelevizive detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

Qëllimi kryesor i veprimtarisë së një autoriteti rregullator në sektorin audioviziv është rregullimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radiotelevizive publike dhe private në përputhje me legjislacionin.

Në kontekstin formal, të diktuar nga legjislacioni, viti 2008 nuk ka sjellë ndonjë ndryshim nga vitet e tjera. Nga ana tjetër, duke analizuar në brendësi, përse i përket përmbajtjes së punës që është realizuar në përmbushje të këtij qëllimi, atëherë padyshim që dallohet ndryshimi nga viti precedent. Ky vit, prezantoi zhvillime pozitive në drejtim të forcimit të rolit ligjor e institucional të KKRT-së, përmirësimit të zbatimit të ligjit nga operatorët, dhe mbi të gjitha, u hodhën hapa konkretë në kryerjen e reformave të nevojshme në fushën e mediave elektronike, reforma këto të kërkuara edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Arritjet më të rëndësishme KKRT dhe gjithë veprimtaria vjetore pasqyrohen me gjerësisht në pjesën vijuese të raportit, ku analizohen sipas problematikave.

1 STRATEGJIA E KALIMIT NGA SISTEMI ANALOG NË ATË NUMERIK

“Ka pasur progres në politikën audiovizuale. Strategjia për kalimin në transmetimet numerike po projektohet në bashkëpunim me organe ndërkombëtare dhe aktorët kryesorë”¹

Kalimi nga transmetimet radiotelevizive analoge në ato numerike, i përcaktuar si një proces prioritar në të gjitha vendet evropiane, konsiderohet një nga sfidat më të mëdha në fushën e mediave elektronike me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare.

Për të përballuar këtë sfidë dhe për të përfituar nga ky zhvillim i ri teknologjik, është konsideruar e nevojshme identifikimi dhe zbatimi i hapave dhe masave konkrete që duhet të ndërmerren në këtë drejtim. Eksperienca e vendeve të tjera që tashmë e kanë nisur këtë proces, ka treguar se një kalim i suksesshëm në këtë sistem, kërkon formulimin e një strategjie të detajuar, e cila duhet të përcaktojë procesin, burimet dhe kohën që duhet të nevojitet për zbatimin e saj, me qëllim që të adresohen në mënyrë të duhur problemet e së tashmes dhe të së ardhmes.

Duke qenë se nga pikëpamja institucionale i takon Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit që ta shoqërojë këtë kalim, KKRT-ja hodhi hapin e parë në nisjen e punës për hartimin e një strategjie të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Konkretisht, KKRT-ja, në bashkëpunim të ngushtë me Prezencën e OSBE-së, gjatë periudhës prill-qershor dhe nëntor-dhjetor 2008, ndërmori një proces të gjerë këshillimi publik për marrjen e opinioneve, mendimeve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjithë operatorët radio-televizivë duke përfshirë dhe institucionet shtetërore me qëllim hartimin e strategjisë së kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Tashmë, ka përfunduar projekti final i strategjisë, në të cilën janë përcaktuar format dhe rrugët e këtij kalimi brenda vitit 2012, në funksion të respektimit të afateve kohore të përcaktuara ndërkombëtarisht.

Kjo projekt-strategji parashikon objektivat kryesore dhe parimet e kalimit, formulon rolin e shtetit dhe të strukturave përkatëse të administratës shtetërore në krijimin e kushteve të kalimit në sistemin numerik, vlerësimin e situatës ekzistuese teknike dhe ligjore të peizazhit audio-vizual shqiptar si dhe përcakton hapat, procedurat, kostot dhe afatet e kalimit brenda vitit 2012.

¹ Albania 2008 Progress Report, Brussels 05.11.2008 SEC (2008) 2692 final

Projekt-strategjia është përgatitur, bazuar në analizat që i janë bërë situatës aktuale si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, duke marrë parasysh interesat e konsumatorëve shqiptarë, aspektet financiare të këtij kalimi, aspektet e kapaciteteve të rrjetit, detyrimet e transmetimit si dhe gjendjen apo situatën konkrete të transmetimeve në Shqipëri. Ajo merr parasysh përfitimet e kalimit në sistemin numerik si dhe udhëzimet, konkluzionet, rekomandimet dhe debatet e ndryshme të zhvilluara në Bashkimin Evropian mbi vlerat dhe përfitimet që ofron kalimi në sistemin numerik.

Projekt-strategjia fokusohet, në përcaktimin e rrugës dhe fazave që do të ndjekë kalimi në sistemin numerik, ndërmarrjen e hapave ligjorë, institucionalë dhe teknikë që do ta shoqërojnë atë si dhe nevojën e bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë aktorët e përfshirë.

Përcaktimi i instrumenteve rregullatorë, është një tjetër element pozitiv i kësaj projekt-strategjie, në mënyrë të veçantë për sa i përket ndërhyrjeve të politikës publike (p.sh. fushatave informuese për konsumatorët apo përcaktimit të rolit të televizionit publik shqiptar në procesin e dixhitalizimit); masave rregullatore apo mekanizmave të mbështetjes financiare.

Kjo projekt-strategji përqipet të zgjidhë dhe adresojë, në mënyrë të veçantë, rrugët apo alternativat që duhet të ndiqen për kalimin në sistemin dixhital. Nisur nga zhvillimi i këtij procesi në vendet e tjera, në këtë dokument janë paraqitur dy skenarë të mundshëm:

Së pari, kalimi apo përqasja e "butë", në të cilën periudha e tranzicionit do të jetë relativisht e gjatë. Operatorët ekzistues analogë që do të kalonin në këto platforma numerike do të jenë të detyruar të ruajnë transmetimet në rrjetin ekzistues analog për aq kohë sa pjesa më e madhe e popullsisë të pajiset me dekoderë. Transmetimet simulcast (të njëkohshëm) do të vononin lirimin e frekuencave të planit numerik të okupuara nga transmetimet analoge që nga ana e saj do të pengonte ndërtimin e platformave të reja numerike. Ky skenar është skenari që do të kërkojë përdorimin e një numri më të lartë frekuencash, kërkesë që në disa zona specifike nuk do të mund të plotësohej.

Së dyti, kalimi apo përqasja e 'fortë', në të cilën parashikohet kalimi në transmetime tërësisht numerike të rajoneve të veçanta duke mbyllur krejtësisht transmetimet analoge në to. Ky skenar që njihet me emrin skenari i "ishujve numerikë" redukton në minimum kohën e tranzicionit, rrjedhimisht edhe kohën e transmetimeve simulcast për rajone të caktuara. Përcaktimi i saktë i prioriteteve të krijimit të "ishujve numerikë" dhe subvencionimi i dekoderëve sidomos për kategori të caktuara teleshikuesish, mund të garantonte suksesin e aplikimit të këtij skenari.

Procesi i kalimit nga sistemi analog në atë numerik, është një proces kompleks dhe i vështirë, që kërkon një bashkëpunim ndër-institucional, për kalimin me

sukses në sistemin numerik. Për këtë arsye, nisur edhe nga praktikat e vendeve të tjera, në projekt-strategji është parashikuar ngritja e një "Task-Force" të një niveli ndër-institucional dhe teknik, e aftë të drejtojnë këtë ndryshim të peizazhit audio-vizual shqiptar.

Në këtë projekt-strategji, është propozuar që përbërja e Task-Forcës në nivel teknik, të drejtohet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, si enti rregullator në këtë fushë, në përbërje të së cilës të jenë edhe ekspertë teknikë të fushës, juristë, ekonomistë, përfaqësues nga shoqatat e konsumatorëve etj. Kjo Task-Forcë në nivel teknik, e ndihmuar edhe nga një Sekretariat si strukturë koordinuese, do të përgatisë të gjitha hapat dhe procedurat që do të kërkonte ky proces deri në kalimin e plotë në sistemin numerik.

Task-Forca ndër-institucionale, do të ishte struktura vendimmarrëse, e cila do të shqyrtonte dhe vlerësonte të gjitha propozimet e paraqitura nga Grupi Teknik. Kjo Task-Forcë do të duhet të funksionojë gjatë gjithë periudhës tranzitore të kalimit nga sistemi analog në atë numerik, në përbërje të së cilës mund të jenë përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Autoriteti i Konkurrencës, ZSHDA si dhe përfaqësues nga KKRT dhe Komuniteti i Mediave Elektronike (Mediave kombëtare, lokale si dhe nga televizioni publik).

Këto struktura do të funksionojnë gjatë gjithë periudhës tranzitore, dhe do të koordinojnë të gjithë procesin e zbatimit të strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Është shumë e rëndësishme, për vetë rëndësinë e këtij procesi dhe kohën në dispozicion, që të mundësohet sa më shpejt që të jetë e mundur, ngritja dhe funksionimi i këtyre strukturave, si një hap themelor drejt realizimit të procesit të dixhitalizimit.

Në këtë projekt-strategji, është parashikuar dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm legjislativë nëpërmjet ndërhyrjeve në kuadrin ekzistues ligjor, për të mundësuar lehtësimin e këtij kalimi, dhe ku roli i Kuvendit të Shqipërisë konsiderohet themelor.

2 KUADRI LIGJOR, RREGULLIMI DHE MBIKQYRJA E VEPRIMTARISË RADIO TELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE

Gjatë vitit 2008 KKRT, ka kryer aktivitetin e saj në bazë të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", dhe gjithë kuadrit ligjor që lidhet me punën e saj dhe fushën e medias. Në bazë dhe në zbatim të këtyre ligjeve, KKRT ka miratuar akte nënligjore, si rregullore dhe vendime, me qëllim, kontrollin, mbështetjen dhe përmirësimin e gjithë veprimtarisë radiotelevizive.

KKRT është përqendruar në përmbushjen e disa prej kompetencave kryesore të saj, si kontrolli i zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues nga subjektet radiotelevizive, sugjerimi i ndryshimeve në legjislacion dhe rregulloreve, garantimi i konkurrencës së ndershme në fushën e mediave elektronike, etj., duke realizuar konkretisht: hartimin e propozimeve për ndryshime në akte ligjore dhe nënligjore, ndjekjen e procedurave të licencimit e ri-licencimit të subjekteve radiotelevizive, mbikëqyrjen e respektimit të kushteve të licencës, respektimin e të drejtave të transmetimit, vendosjen e sanksioneve, ndjekjen e proceseve gjyqësore, ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve, etj.

Gjatë vitit 2008, nga KKRT janë marrë gjithsej 92 vendime. Këto vendime lidhen kryesisht me shqyrtimin e aplikimeve për licencime, ri-licencime, shqyrtime dokumentacioni për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në kërkesat për marrjen e licencës tek operatorët Radio Televizivë, sanksione të vëna për subjekte të ndryshëm radiotelevizive, vendime që lidhen me miratimin e rregulloreve dhe ndryshimin e tyre, apo që rregullojnë probleme të tjera të sektorit.

2.1 Legjislacioni dhe ndryshime

Sikundër përmendëm, gjatë vitit 2008, KKRT ka zbatuar gjatë veprimtarisë së saj edhe ligjin nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", ligj i cili plotësoi pjesërisht legjislacionin e medias elektronike dhe hapi rrugën për mundësinë e licencimit të transmetimeve numerike.

Megjithatë, KKRT ka konstatuar se në legjislacionin ekzistues, vazhdojnë të ekzistojnë boshllëqe që bëjnë të mbetet parësore kryerja e një reforme të plotë ligjore.

Reforma e plotë ligjore në fushën audiovizuale ndihet gjithmonë e më shumë e nevojshme për shkak të dy faktorëve të rëndësishëm:

Së pari, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, kërkon harmonizimin e plotë të legjislationit (edhe atë të sektorit audiovizual) me *acquis communautaire* dhe përjasjen e tij me standardet e praktikat më të mira evropiane.

Së dyti, legjislationi aktual, pavarësisht përpjekjeve për plotësim, përsëri nuk i përgjigjet realitetit teknologjik, por njëkohësisht shihet i pamjaftueshëm për të realizuar procesin e kalimit plotësisht në transmetime numerike brenda vitit 2012 (afat të përcaktuar në ligjin nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë" dhe nga angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë²).

Pikërisht nisur nga kjo nevojë për reformë në legjislationin ekzistues, një aspekt i rëndësishëm i punës së KKRT-së, gjatë këtij viti, ka qenë edhe evidentimi i mangësive dhe përgatitja e propozimeve për ndryshimin e tij.

Një ligj modern integral, i cili parashikon licencimin e gjithë llojeve të teknologjive të reja dhe që ofron një treg më të larmishëm e pluralist audiovizual është i domosdoshëm për respektimin e standardeve evropiane dhe reformimin e sektorit.

KKRT ka evidentuar shumë probleme, që nuk gjejnë zgjidhje apo janë të parregulluara plotësisht në legjislationin aktual, të tilla si: mjete konkrete dhe efikase për realizimin e procesit të kalimit në transmetime numerike; garantimi i kalimit në transmetim numerik të gjithë programeve ekzistuese, ruajtja larmisë së tyre dhe e pluralizmit ekzistues; rregullimi i teknologjive të reja, mbrojtja e konsumatorëve nga procesi i ndryshimit të transmetimeve, dhe plot probleme të tjera që lindin për shkak të mos harmonizimit me njëri-tjetrin të ligjit nr. 8410 (Për radion dhe televizionin publik dhe privat) me ligjin nr. 9742 (për transmetimet numerike).

Nga Kuvendi i Shqipërisë, prej rreth një vit më parë u iniciua procesi për reformë të plotë ligjore në fushën e medias elektronike, madje duke përfshirë në të edhe ekspertizën e strukturave të Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, si një garanci më shumë në realizimin e saj në përputhje të plotë me standardet evropiane. Megjithatë, ky proces ende nuk ka përfunduar. KKRT disa herë i ka kërkuar Kuvendit përsheptimin e punës në këtë drejtim, duke transmetuar edhe parimisht propozimet për ndryshime në legjislation.

² Ligjet "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radio-Komunikacionit për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesët e rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06)" dhe "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radio-Komunikacionit për rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit (1961), miratuar nga Kuvendi më datë 27.12.2007, përcaktojnë se periudha e tranzicionit (bashkekzistenca e transmetimeve analoge dhe numerike) përfundon më 2015 (GE06). Vendet e CEPT (Konferenca Evropiane e Postave dhe Telekomunikacioneve, ku bën pjesë dhe Shqipëria), kanë vendosur që kjo periudhë të përfundojë më 2012.

Nga ana tjetër, ajo vetë ka hartuar propozime të vlefshme dhe do të bëjë përpjekjet maksimale që këto propozime të jenë pjesë e një ligji të ri, ku të pasqyrohet në harmoni të plotë, si eksperiencia e akumuluar në këto vite nga KKRT në këtë fushë, ashtu edhe praktikat e standardet e vendeve të Bashkimit Evropian.

Një hap tjetër i rëndësishëm gjatë këtij viti ka qenë dhe hartimi apo përmirësimi i rregulloreve, në kuadër të zbatimit të ligjit për transmetimet numerike, ashtu dhe në zbatim të ligjit organik të KKRT-së. Kështu, në zbatim të ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", që e ngarkon KKRT me nxjerrjen e akteve nënligjore, si dhe me qëllim garantimin e konkurrencës së ndershme e respektimin e pluralizmit në median audiovizuale, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me Vendimin nr. 696, datë 14.04.2008, ka miratuar Rregulloren "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive".

Miratimi nga KKRT i Rregullores "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive", erdhi pas një procesi të gjatë pune, konsultimesh me ekspertë dhe duke marrë në të njëjtën kohë edhe mendimet e operatorëve radiotelevizivë. Ishte procesi i hartimit të kësaj rregulloreje që evidentoi një sërë mangësish në ligjin e ri "Për transmetimet numerike", por që njëkohësisht detyroi KKRT të përpqej të plotësonte³ këto mangësi dhe të realizonte rregullimin më të mirë të mundshëm, me qëllim që të arrihej një nga prioritetet dhe angazhimet e KKRT-së për 2008, licencimi i operatorëve të parë numerik. Në fakt KKRT në nëntor të këtij vitin inicioi procedurat për licencimin e tre rrjeteve të parë numerikë kombëtarë.

Gjatë këtij viti, KKRT miratoi edhe një ndryshim në rregulloren e saj "Për mesazhet me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë", që parashikon mesazhe që transmetohen falas nga operatorët radiotelevizivë. Ky ndryshim mori shkas nga kërkesa për bashkëpunim e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut pranë Ministrisë së Shëndetësisë, sipas së cilës, kërkohej shtimi në rregulloren e sipërcituar të KKRT-së, edhe i mesazheve promovionale për dhurimin vullnetar e falas të gjakut, si mesazhe me dobi shoqërore.

Kështu, KKRT, me Vendimin nr. 691, datë 31.03.2008, bëri një shtesë në Rregulloren "Për mesazhet me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë", ku parashikohet se transmetohen falas nga operatorët radiotelevizivë edhe "mesazhet e Ministrisë së Shëndetësisë, që lidhen me dhurimin vullnetar e falas të gjakut". Ky ndryshim, i'u dërgua të gjithë operatorëve radiotelevizivë, duke i'u kërkuar këtyre të fundit respektimin dhe zbatimin me rigorozitet të rregullores së sipërcituar në tërësi.

³ Brenda mundësisë dhe kufizimeve që vetë ligji i jep për nxjerrjen e akteve nënligjore.

2.2 Licencimet

Një nga objektivat prioritarë KKRT-së për vitin 2008 ishte licencimi i operatorëve të parë numerikë. Nisur nga ky prioritet, mbështetur dhe në kërkesat e tregut, KKRT pa të arsyeshme nisjen e procedurave të licencimit të operatorëve të parë.

Licencimi i shërbimeve dhe programeve të mbështetura në rrjetet numerike do të forcojë veprimin e ligjit edhe në këtë sektor shumë sensitiv për përdoruesit, shoqërinë në përgjithësi, autoritetet shtetërore dhe ekonominë e sektorit në veçanti.

Në mbështetje të ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Rregullores "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive", si dhe Vendimit nr. 726, datë 08.09.2008 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë të rrjeteve numerike tokësore kombëtare", në muajin Nëntor 2008, KKRT shpalli organizimin e konkurrimit publik⁴ të kandidaturave për subjektet e interesuar për t'u licencuar për operatorë privatë rrjeti numerik tokësor kombëtar. Në garë u shpallën 3 (tre) rrjete numerike dhe afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e aplikimeve, u caktua data 24.11.2008.

Me kërkesat e aplikantëve, data e konkurrimit u shty disa herë. Në datën e fundit, 21.01.2009, konkurrimi nuk u realizua sepse nuk u paraqit asnjë kandidat.

Nga ana tjetër, KKRT, nisur nga kërkesat dhe në përmbushje të kompetencave të veta ligjore, gjatë këtij viti ka vazhduar të licencojë subjekte radiotelevizive analogë. Licencimi e ri-licencimi i subjekteve radiotelevizive analogë kryhet në bazë të ligjit nr. 8410 nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 7 dhe 25).

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2008, në KKRT janë paraqitur një numër i konsiderueshëm kërkesash për licencime, për rinovime licencash si dhe për zgjerime zonash transmetimi. Një numër të konsiderueshëm të këtyre kërkesave e zënë ato për operatorë televizive privatë kabllorë. KKRT, në bazë të shqyrtimit të dosjeve të aplikimit ka bërë dhe licencimin ose jo të subjekteve.

Një nga objektivat prioritarë KKRT-së për vitin 2008 ishte licencimi i operatorëve të parë numerikë. Nisur nga ky prioritet, mbështetur dhe në kërkesat e tregut, KKRT pa të arsyeshme nisjen e procedurave të licencimit të operatorëve të parë.

⁴ Njoftimi për organizimin e konkurrimit publik u botua në gati të gjitha organet e medias së shkruar. Njëkohësisht u transmetua në rubrikat e njoftimeve dhe teletekstin e operatorit publik RTSH.

Licencimi i shërbimeve dhe programeve të mbështetura në rrjetet numerike do të forcojë veprimin e ligjit edhe në këtë sektor shumë sensitiv për përdoruesit, shoqërinë në përgjithësi, autoritetet shtetërore dhe ekonominë e sektorit në veçanti.

Në mbështetje të ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Rregullores "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive", si dhe Vendimit nr. 726, datë 08.09.2008 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë të rrjeteve numerike tokësore kombëtare", në muajin Nëntor 2008, KKRT shpalli organizimin e konkurrimit publik⁵ të kandidaturave për subjektet e interesuar për t'u licencuar për operatorë privatë rrjeti numerik tokësor kombëtar. Në garë u shpallën 3(tre) rrjete numerike dhe afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e aplikimeve, u caktua data 24.11.2008.

Me kërkesat e aplikantëve, data e konkurrimit u shty disa here. Në datën e fundit, 21.01.2009, konkurrimi nuk u realizua sepse nuk u paraqit asnjë kandidat.

Nga ana tjetër, KKRT, nisur nga kërkesat dhe në përmbushje të kompetencave të veta ligjore, gjatë këtij viti ka vazhduar të licencojë subjekte radiotelevizive analogë. Licencimi e ri-licencimi i subjekteve radiotelevizive analogë kryhet në bazë të ligjit nr. 8410 nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 7 dhe 25).

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2008, në KKRT janë paraqitur një numër i konsiderueshëm kërkesash për licencime, për rinovime licencash si dhe për zgjerime zonash transmetimi. Një numër të konsiderueshëm të këtyre kërkesave e zënë ato për operatorë televizivë privatë kabllorë. KKRT, në bazë të shqyrtimit të dosjeve të aplikimit ka bërë dhe licencimin ose jo të subjekteve.

Gjatë vitit 2008 KKRT-ja ka licencuar gjithsej 12 subjekte radiotelevizive⁶. Këto subjekte janë:

1. Një subjekt për operator televiziv analog privat kombëtar, konkretisht subjekti:
 - TV "Top Channel".
2. Një subjekt për operator televiziv privat satelitor, konkretisht subjekti:
 - TV "Vizion +".
3. Dy subjekte për operatorë televizivë privatë analogë vendorë, dy subjekte për operatorë radiofonikë analogë privatë vendorë dhe gjashtë subjekte për operatorë televizivë privatë kabllorë, konkretisht si më poshtë vijon:

⁵ Njoftimi për organizimin e konkurrimit publik u botua në gati të gjitha organet e medias së shkruar. Njëkohësisht u transmetua në rubrikat e njoftimeve dhe teletekstin e operatorit publik RTSH.

⁶ Vitin e shkruar numri total i licencimeve ka qenë 4.

- TV vendor Preza (Komuna Prezë)
- TV vendor D1 (Rrethi Peshkopi)
- Radio Idea (Qyteti Vlorë)
- Radio City (Rrethi Tiranë-Durrës)
- TV kabllor Divjaka (Divjakë)
- TV Kabllor S3 (Vorë, Sukth, Marikaj)
- TV Kabllor Delta (Çërravë)
- TV Kabllor Orikum (Orikum)
- TV Kabllor Danja (Vau i Dejës)
- TV Kabllor Përrenjas (Përrenjas)

Duhet të theksojmë se KKRT, me licencimin e subjektit "Top Channel" si operator kombëtar, jo vetëm ju përgjigj kërkesave të tregut, por hodhi një hap tjetër drejt liberalizimit dhe zhvillimit të tregut mediatik.

Nga ana tjetër, edhe licencimi i një tjetër subjekti, "Vizion +", si operator televiziv satelitor është vazhdim i përpjekjeve të KKRT-së për garantimin efektiv të konkurrencës, barazisë dhe rritjes së cilësisë të peizazhit audiovizual në Shqipëri.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë miratuar dhe një numër i konsiderueshëm kërkesash për rinovim licence, e konkretisht 11 subjekte, në mbështetje të ligjit 8410, si dhe në mbështetje e në zbatim të procedurave të përcaktuara në Rregulloren "Mbi procedurat e ri-licencimit të operatorëve radiotelevizivë".

Subjektet të cilave me vendim KKRT i'u është rinovuar licenca janë si më poshtë vijon:

- "Radio 7"
- "Radio Parë Mat"
- "Radio Sport"
- "Radio ABC"
- "Radio Lezha"
- "Radio Boom Boom"
- "Radio Club Alsion"
- "Radio Star"
- "TV Shijak"
- "TV ABC"
- "TV BBF"

KKRT, mbështetur në të drejtën që ka për kontrollin e veprimtarisë radio televizive, ka marrë edhe vendime për heqje, mos-rinovime, apo mosdhënie licencash për disa subjekte të cilat nuk kanë respektuar kushtet dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe në licencë.

1. Heqje dhe pavlefshmëri licencash:

- "TV Kabllor Synej"
- "TV Kabllor DCN"

2. Mos-rinovim dhe pavlefshmëri licence:

- "TV Kabllor Butrinti"
- "Radio Perla"

3. Mos dhënie licence:

- "TV Kabllor Dushk"
- "TV Kabllor Lushnjë"
- "Radio Spartak SM"
- "Radio Vlora"
- "Radio Jehona"
- "TV Dyrrah"
- "Radio Dajçi"
- "TV EVA"
- "Radio Alfa-Kabëll"
- "Radio G-Kam"

Në përputhje me ligjin 8410 dt. 30.09.1998, i ndryshuar, neni 7 pika 5 vendimet e KKRT për dhënien dhe heqjen e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare.

Sanksionet

Një nga detyrat kryesore dhe funksionale të KKRT-së ishte edhe kontrolli i respektimit të kushteve të licencës si detyrim i përcaktuar në ligj, nga subjektet radiotelevizivë.

KKRT, në rastet kur konstaton shkelje të ligjit apo kushteve të licencës, ndërmerr sanksionet përkatëse ndaj subjekteve radiotelevizivë kundërvajtës, mbështetur në nenin 137, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, që i jep KKRT-së të drejtën të vendosë sanksione, jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

Pavarësisht se nuk parashikohen si sanksione të mirëfillta, KKRT mund të përdorë si "mjet ndëshkues" edhe mos-rinovimin e licencës dhe shpalljen e pavlefshme të saj. Mundësia e mos-rinovimit të licencës është një masë mbikëqyrëse, veçanërisht, e rëndësishme dhe me dobi të madhe praktike, sidomos për operatorët që gjatë kohëzgjatjes së licencës janë treguar jo të rregullt me plotësimin e detyrimeve të tyre⁷.

⁷ Psh. këtë vit nuk është rinovuar licenca e subjekteve TV Kabllor Butrinti, Radio Perla.

Gjithashtu, bërja e pavlefshme e saj për shkak të mos pagimit të detyrimeve financiare, është një mjet tjetër efikas për të vepruar mbi operatorët që nuk paguajnë detyrimet e licencës⁸.

Në raport me vitet e tjera, gjatë vitit 2008 është vënë re një korrektësi dhe një ndërgjegjësim më i madh i operatorëve radiotelevizivë në respektimin dhe zbatimin e akteve ligjore në fuqi dhe kushteve të licencës që rregullojnë veprimtarinë radiotelevizive. Në disa raste, operatorët janë mjaftuar vetëm me sanksionin e paralajmërimit, për të ndaluar mosrespektimin e dispozitave ligjore apo për mospërsëritjen e ndonjë shkeljeje.

Megjithatë, për disa subjekte radiotelevizivë, janë vendosur edhe sanksione me gjobë. Si rregull, sanksioni i paralajmërimit jepet i pari. Kjo është në përputhje me ligjin dhe praktikën e KKRT-së, sipas së cilës një numër i shkallëzuar sanksionesh ofron mundësi më të mira për një kontroll efektiv, se në rastin kur organi mbikëqyrës kufizohet vetëm me masa drastike.

Konkretisht, sanksionet me gjobë të vendosura gjatë vitit 2008, janë gjithsej 3 (tre) dhe janë vendosur për dalje në transmetim pa autorizimin dhe licencimin e KKRT-së, për pirateri dhe një gjobë për mosrespektim të dispozitave ligjore për reklamat radiotelevizive, si më poshtë:

Pasqyra e gjobave për vitin 2008

Nr.	Subjekti	Numri	Data	Shkaku	Vlera
1.	Radio Sandra	0180	31.01.2008	Dalja në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së	200.000 lekë, lënë në fuqi me vendimin nr. 689, datë 31.03.2008, të KKRT-së
2.	TV News 24	0181	02.09.2008	Mosrespektim i dispozitave për reklamat	800.000 lekë, lënë në fuqi me vendimin 727, dt. 24.09.2008, të KKRT-së
3.	TV AVN	0182	23.09.2008	Transmetim pa të drejta transmetimi të programeve radiotelevizive	500.000 lekë, lënë në fuqi me vendimin nr. 749, datë 07.11.2008, të KKRT-së

⁸ Subjekteve TV Kabllor Synëj, TV Kabllor DCN iu është bërë e pavlefshme licenca si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve financiare.

2.3 Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së

Ekzekutimi i vendimeve është një aspekt i rëndësishëm që ndikon në forcimin e autoritetit të KKRT-së. Për vitin 2008, KKRT mbështetur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka mundur të ekzekutojë një pjesë të mirë të vendimeve të saj, me gjithë pakënaqësitë dhe pengesat që kanë shfaqur operatorët radiotelevizivë.

Në mbështetje të neneve 10/a dhe 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur midis institucioneve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Task-Force) me ndihmën e inspektorëve të KKRT-së, ka bërë të mundur zbatimin e urdhrave të mëposhtëm:

- Urdhrit nr. 84, datë 31.07.2007 "Për mbylljen e aktivitetit transmetues të subjektit "Radio Stinët".
- Urdhrit nr. 109, datë 22.05.2008 "Për ekzekutimin e gjobës ndaj subjektit "TV 6+1".
- Urdhrit nr. 28, datë 14.04.2008 "Për mbylljen e aktivitetit transmetues të subjektit "Radio New Planet".
- Urdhrit nr. 4 datë 31.01.2008 "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të operatorit radiofonik Radio Sandra".

Ky bashkëpunim ka rezultuar relativisht i mirë, duke bërë që të vendosen rregulla dhe praktika frytdhënëse.

2.4 Raportimi i ndryshimeve nga operatorët

"Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve" nga subjektet radiotelevizive është një detyrim ligjor, parashikuar edhe si një ndër kushtet e licencës, dhe për të cilin parashikohet edhe sanksion me gjobë në rast mosrespektimi.

Ky detyrim i parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ka si qëllim vënien në dijeni dhe njohjen e KKRT-së me çdo ndryshim të të dhënave që i licencuari ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës, të tilla si: ndryshimet në pronësi, që është nga më të rëndësishmit, ndryshimet në administrimin apo drejtuesin e shoqërisë, emrin e transmetuesit radio ose televiziv, përmbajtjen e programeve që transmeton, selinë e adresën e subjektit, dhe të tjera ndryshime që kanë të bëjnë me kushtet me të cilat dhe për të cilat një subjekt i caktuar është licencuar. Me këtë dispozitë, KKRT ka mundur të detyrojë subjektet radiotelevizive që t'i përmbahen dispozitave ligjore dhe kushteve të licencës, edhe kur ndryshojnë ndonjë nga të dhënat e tyre.

KKRT, i'u ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen të gjithë subjekteve, lidhur me këtë detyrim, me qëllimin që për çdo ndryshim të të dhënave, (sidomos

përsa i përket ndryshimeve që mund të kryhen nga subjektet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit), të depozitojnë njoftimin dhe të kërkojnë miratimin e KKRT-së, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve.

Gjatë vitit 2008, në mënyrë që veprimtaria e subjekteve radiotelevizivë në këtë aspekt të ndiqet në vazhdimësi, KKRT ka bërë verifikimin e herëpashershëm të gjendjes së subjekteve, duke iu drejtuar me kërkesën për informacion Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), ose kontrolluar direkt faqen zyrtare të internetit të tyre.

Megjithatë duhet theksuar se në raport me vitet e tjera, vihet re një ndërgjegjësim e korrektësi më e madhe e subjekteve radiotelevizivë për respektimin e detyrimit të sipërcituar ligjor.

2.5 Respektimi i së drejtës së transmetimit dhe të drejtave të autorit

Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, është pjesë thelbësore e garantimit të konkurrencës së ndershme dhe ekuilibrit të tregut mediatik.

Gjatë vitit 2008, puna është përqendruar në sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e operatorëve radiotelevizivë, mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave të transmetimit dhe të autorit dhe zhdukjen e fenomenit të "piraterisë radiotelevizive".

Përqendrimi i vëmendjes tek sensibilizimi, parë si masë parandaluese e fenomenit, është bërë duke u nisur edhe nga konstatimi se, penalizmi i shkeljes së këtyre të drejtave jo gjithmonë ka sjellë rezultatet e pritshme. Ky evidentim është i lidhur edhe me zvarritjet e pafund të proceseve gjyqësore që lidhen me piraterinë radiotelevizive dhe me mosnjohjen e trajtimit të konflikteve që prekin pronësinë intelektuale dhe të drejtat e transmetimit nga gjykatat. Ky është një problem që duhet të zgjidhet sa më parë nëpërmjet krijimit në gjykata të seksioneve të specializuara ose me trajnimin e njohjen në mënyrë të veçantë të gjyqtarëve me të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

Si rezultat i tërheqjes së vazhdueshme të vëmendjes së operatorëve⁹, gjatë këtij viti ka pasur një rritje të numrit të depozitimeve të marrëveshjeve për kalimin e të

⁹ Nëpërmjet kujtesave të herëpashershme dhe kërkesave për dorëzimin e dokumentacionit që vërteton të drejtat e transmetimit të programeve të tyre.

drejtave të transmetimit mes subjekteve transmetuese shqiptare, apo mes tyre dhe subjekteve të huaja.¹⁰

Angazhimi serioz i KKRT-së për eliminimin e transmetimeve pirate dhe respektimin e pronësisë intelektuale, ka bërë që në krahasim me vitet e mëparshme numri i transmetimeve të paligjshme të ulet në mënyrë të ndjeshme. Tashmë janë të identifikuara, jo vetëm transmetimet e veçanta të programeve me të drejta transmetimi si filma, ndeshje sportive, dokumentarë apo koncerte, por edhe formate të mirëfillta televizive, e drejta e transmetimit e të cilave është pronë e kompanive të fuqishme distributore në Evropë dhe në botë. Kjo tregon se tregu audiovizual në Shqipëri po përshtatet me rregullat e vendosura në tregun mediatik evropian.

Blerja e të drejtave të transmetimit dhe respektimi i tyre nga operatorët radiotelevizivë, tregon ndërgjegjësimin e operatorëve se skema e respektimit të të drejtave të transmetimit, është e vetmja formë e funksionimit në tregun mediatik. Kjo shihet për shembull, nga blerja e evenimenteve më të rëndësishme sportive si: Champions League e kampionate të tjera të njohura evropiane; apo blerja e formateve tashmë të licencuara si "Big Brother", "Ti Vlen", Milioner etj.

Në luftën kundër "piraterisë radiotelevizive", është e rëndësishme edhe vendosja e kontakteve dhe lidhjeve të drejtpërdrejta me distributorë e producentë të huaj e vendas, të cilët janë tepër të interesuar për të paraqitur ecurinë e zbatimit të marrëveshjeve me subjektet televizive shqiptare dhe njëkohësisht për të zgjidhur nëpërmjet rrugëve ligjore, rastet e shkeljes së të drejtave mbi pronësinë intelektuale që ata përfaqësojnë.

Në fakt, gjatë këtij viti, janë vendosur kontakte të tilla frytdhënëse me përfaqësuesit e "Eurosport", "Euronews", National Geographic, Albator, Unison, Powercorp International Limited, Televisa-sa etj. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të kontrollit të ligjshmërisë së transmetimeve.

Një nga aspektet e punës për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit, është edhe bashkëpunimi me strukturat dhe institucionet shtetërore që kryejnë aktivitet në këtë fushë. KKRT, në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit apo memorandumeve të nënshkruara me institucione të tilla, si Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, Autoritetin e Konkurrencës, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, etj., ka intensifikuar marrëdhëniet me këto institucione për të forcuar bashkëpunimin në monitorimin dhe garantimin e respektimit të të drejtave të autorit.

KKRT është e bindur se, vetëm nëpërmjet bashkëpunimit midis institucioneve mund të minimizohet "pirateria radiotelevizive". As KKRT dhe as ZSHDA me

¹⁰ Rreth 60-65% e televizioneve analoge kanë paraqitur vetë dhe në kohë kontratat apo marrëveshjet që vërtetojnë të drejtat e transmetimit të programeve të tyre. Po kështu, edhe rreth 60% e subjekte televizive kabllorë kanë respektuar këtë detyrim.

agjencitë e licencuara prej saj, nuk mund ta kryejnë të vetëm mbikëqyrjen e këtij detyrimi të ndërlikuar.

Megjithatë, një problem i konstatuar nga bashkëpunimi me ZSHDA-në, ka të bëjë me mjaft ankesa nga operatorët radiotelevizivë, lidhur me tarifat e aplikuara nga ZSHDA dhe agjencitë e administrimit kolektiv, mbi vlerat e kontratave të blerjeve të të drejtave të transmetimit apo edhe certifikimit të tyre. Vendosja e tarifave reale dhe vjelja e tyre është e lidhur drejtpërdrejtë edhe me shkallën e respektimit të të drejtave të autorit. Pikërisht në këtë drejtim, kërkohet një bashkërendim më i madh i punës dhe politikave mes dy institucioneve tona.

Duhet theksuar se Shqipëria, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ka marrë përsipër angazhime konkrete në fushën audiovizuale në përgjithësi, dhe "...në mënyrë të veçantë me rregullat e pronësisë intelektuale të zbatueshme në programet dhe transmetimet e tyre..." (neni 102 i MSA). Ky detyrim e bën luftën kundër "piraterisë radiotelevizive" dhe respektimin e të drejtave të autorëve mjaft të rëndësishme për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë këndvështrim, thellimi i politikave strategjike dhe masave ligjore për monitorimin, mbrojtjen dhe respektimin e këtyre të drejtave i bashkëngjitet objektivave të ardhshëm të institucionit të KKRT-së.

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga MSA, harmonizimi i legjislacionit të kësaj fushe me "acquis communautaire" është një tjetër detyrim për Shqipërinë. KKRT në propozimet për projektligjin e ri të medias elektronike ka mbajtur parasysh edhe direktivat e BE që lidhen me të drejtën e transmetimeve.

Gjithashtu, KKRT ka paraqitur opinionin e vet edhe lidhur me projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", që synon pikërisht harmonizimin e legjislacionit të të drejtave të autorit me atë evropian.

2.6 Çështjet gjyqësore

E drejta për t'u ankuar në gjykatë, lidhur me aktet administrative të administratës shtetërore, nga subjektet e prekura nga këto vendime, është një e drejtë ligjore, që e ka bërë KKRT-në palë në shumë procese gjyqësore.

Zakonisht ankimohen në gjykatë vendimet e KKRT-së lidhur me mos-licencime, mos-rinovime licence, pavlefshmëri licence, vendosje gjobe, etj. Pra në pjesën më të madhe proceset gjyqësore kanë si objekt konfliktet me operatorë të ndryshëm radiotelevizivë, por ka dhe çështje me objekt zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, shpërblim dëmi etj.

Shumë prej çështjeve gjyqësore trashëgohen nga viti në vit, si pasojë e zgjatjeve shpesh të pajustificuara nga gjykatat, duke bërë që gjykimi i tyre të vazhdojë për disa vite rresht. Për këta arsye, shumica e proceseve gjyqësore të zhvilluara gjatë vitit 2008 janë të mbartura nga vitet e shkuara.

Procese të iniciuara këtë vit janë gjithsej 3 (tre), nga të cilat vetëm dy kanë ankimuar vendime të KKRT nxjerrë gjatë vitit 2008. Kjo tregon që shumica e vendimeve të KKRT-së, që kanë lidhje me subjekte radiotelevizivë, janë gjetur të drejta, derisa nga këta të fundit, nuk është ushtruar e drejta e ankimit në gjykatë.¹¹

Në total, KKRT ka marrë pjesë në 24 procese gjyqësore, nga të cilat 21 janë akoma në proces gjykimi në Gjykata Rrethi, Apeli dhe në Gjykatën e Lartë, ndërsa 3 janë çështje të përfunduara.

Problematike për KKRT lidhur me proceset gjyqësore mbetet zgjatja disa vjeçare e gjykimeve, që lë pezull apo zvarrit zgjidhjen e konflikteve me operatorët radiotelevizivë.

¹¹ Kuptohet që mund të ketë subjekte që mund ta kenë gjetur jo të drejtë vendimin e KKRT, por që nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre për t'u ankuar edhe për arsye të tjera (personale, mosdashja e përfshirjeve në procese gjyqësore etj.)

3 PROGRAMACIONI

3.1 Situata dhe dukuri programore në media

Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit, edhe gjatë vitit 2008, është kujdesur veçanërisht për zbatimin e ligjit dhe respektimin e kriterëve, parimeve e strukturave programore nga operatorët radiotelevizivë. Në fushën e programeve është ndjekur dhe monitoruar në vijueshmëri programacioni i operatorëve kombëtarë, duke u fokusuar në respektimin e parimeve themelore të ushtrimit e zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive, në rritjen e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së programeve.

Për këtë, Drejtoria e Programeve në KKRT, e ristrukturuar, ka ndërtuar një marrëdhënie kohezive dhe fleksibël mes monitorimit të programeve dhe komunikimit me operatorët radiotelevizivë. Gjithashtu, për problematika të veçanta të fushës së programacionit, i është kushtuar vëmendje edhe mendimeve, ankesave e sugjerimeve të publikut, qoftë të drejtpërdrejta, qoftë përmes shtypit të shkruar. Përzgjedhja dhe sintetizimi i këtyre problematikave ka qenë baza e vendimeve, përgjithësimeve dhe përfundimeve që KKRT ka realizuar në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së operatorëve në përputhje me kërkesat e ligjit, të propozimeve për shtesa e plotësime në aktet ligjore e nënligjore, gjithnjë në interes të publikut.

Kjo marrëdhënie ka mundësuar evidentimin e dukurive të reja në fushën e programacionit, rritjen e cilësisë e të larmisë së programeve, zgjerimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së tyre. Në këtë drejtim, janë vërejtur risi në strukturën programore të disa operatorëve të rëndësishëm radiotelevizivë, përgjegjshmëri gjithnjë e më e lartë në zbatimin e ligjit, vlerësim të çështjeve të etikës radiotelevizive. Theksojmë se nuk ka ndodhur gjithnjë kështu në fushën e respektimit të privatësisë e të të drejtave të individit, ndonjëherë edhe në mediat kombëtare.

Programet në operatorët radioteleviziv kombëtarë, gjatë vitit 2008, u bënë jo vetëm më të larmishme, por edhe më konkurrues. Dëshmi për këtë janë programet e reja "E diela shqiptare" dhe "E diell", përkatësisht në Televizionin KLAN dhe TOP CHANNEL dhe programi i ri i formatit "Reality Show" "Big Brother" (TCH). Për median vizive në Shqipëri, tashmë, përbën një dukuri të pranishme dinamika e këtyre programeve të reja, formati i shtrirë, i konceptuar si një "pasdite" apo një "natë e gjatë" televizive. Tendenca që vihet re është ajo e programeve "autor", me synimin për të përfshirë shtresa e grupmosha të ndryshme të publikut, interesa sa më të gjera, tematika e çështje të mprehta, në dukje të fragmentarizuar, por që konvergojnë me të tërën. E përmendim këtë dukuri që shfaqet në këto lloj programesh, sepse, në tërësinë e tyre, ato

realizojnë cilësisht, një detyrim e funksion të rëndësishëm të operatorëve publikë e kombëtarë, atë formues dhe edukativ.

Veç kësaj, në strukturën programore të operatorëve kombëtarë e vendorë, ka sjellë vlera të qëndrueshme edhe formatimi i ri i programeve të njohura, të ndërthurura me problematika politike e shoqërore, të mprehta e aktuale si "Top Show", "Opinion", "Top Story", "ZIP", "7 x 7", "Ora e debatit" etj., ose edhe programe më të reja si "Puls", "Koha nuk pret", etj. Për audiencë të konsoliduar mund të përmenden edhe programet argëtuese, varietetë komike televizive dhe festivalet apo konkurrimet në fushën e muzikës së lehtë.

Në fushën programore të medias elektronike vijon të mbartet, madje, të thellohet kontradikta midis asaj që bën pjesë në domosdoshmërinë e programeve televizive formuese, edukative e me vlera të prekshme dhe pjesës tjetër që shpreh nevojën për programe komerciale. Këto të fundit, shpesh keqpërdorin tema të caktuara, pa respektuar normat etike dhe morale. Dukuri të tilla janë shfaqur me të njëjtën vijueshmëri në varietetë televizive humoristike dhe në disa emisione që trajtojnë qëndrimin ndaj figurave të regjimit komunist apo krijimtarisë së realizmit socialist. Për këto KKRT është ndalur posaçërisht, ka mbajtur qëndrime që janë materializuar në komunikimet mes institucionit tonë, Këshillit të Etikës dhe operatorëve përkatës.

Me gjithë punën e bërë dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të ndjeshmërisë së operatorëve, programet komerciale kanë ndikuar edhe në programet për fëmijë e të rinj. Këto programe ende shihen si të dorës së dytë, janë të varfra në përmbajtje, pa strukturë të konsoliduar e me gjuhë televizive të papërshtatshme. Funkzioni edukativ e formues, i domosdoshëm për këto lloj programesh që u drejtohen qytetarëve të së nesërme, nuk mbahet gjithnjë parasysh. Prandaj KKRT, në licencimin e ri-licencimin e operatorëve, sidomos të atyre vendorë, ka kërkuar zbatimin e ligjshmërisë dhe të standardeve bashkëkohore, si pjesë e rëndësishme e platformave programore. Tashmë kjo gjë është jo vetëm domosdoshmëri e plotësisht sasiore e cilësore të strukturës programore, për të cilën operatorët radiotelevizivë janë licencuar, por edhe detyrim qytetar e kombëtar.

Me rëndësi jo më pak të vogël janë deformimet e shkeljet e normës gjuhësore, në drejtshkrimin e drejtshqiptimin e gjuhës letrare, që vihet re pothuaj në të gjitha llojet e programeve të medias. KKRT është e bindur se ka ardhur koha për detyrimin, përmes sanksioneve, që operatorët radiotelevizivë të zbatojnë me rigorozitet kërkesën e ligjit për përdorimin e gjuhës letrare kombëtare.

Në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, pas miratimit të raportit të vitit të kaluar, KKRT ka intensifikuar përpjekjet për të rritur rolin dhe ndikimin e vet në rritjen e standardeve dhe të cilësisë së programeve të operatorëve të licencuar. Këtij qëllimi i kanë shërbyer propozimet e sugjerimet tona për përmirësimin e legjislacionit dhe kontaktet e komunikimet e

vazhdueshme institucionale me operatorët e licencuar, seminarët, tryezat e rrumbullakëta, rregulloret, trajtesa në çështje të etikës së programeve të ndryshme, përvojë nga vende të tjera etj.

Në këtë fushë vihet re rritje e përgjegjësisë së operatorëve, sidomos atyre kombëtarë, për domosdoshmërinë e zbatimit të ligjit dhe kërkesave të licencës për programet informative, kulturore ose argëtuese, duke synuar njëherësh standarde bashkëkohore, cilësi më të lartë si dhe një raport më të pranueshëm mes programeve komerciale dhe atyre edukative.

3.2 Mbi etikën në media

Gjatë vitit 2008, Këshilli i Etikës u konsolidua si një organizëm veprues, funksional dhe i pranishëm në veprimtarinë e KKRT-së. Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Programeve ky Këshill ka mundur institucionalizimin e marrëdhënieve me operatorët radiotelevizivë, nëpërmjet Tryezave të Rrumbullakëta, seminareve e komunikimeve, edhe përmes shtypit të shkruar.

Përmendim këtu platformat, temat e diskutimet konkrete, të bëra prezent gjithë operatorëve radiotelevizivë në relacione e seminare të veçanta mbi etikën në media në përgjithësi, e sidomos për çështje ndaj të cilave opinioni publik është shumë i ndjeshëm. Është fjala për parime themelore etike që përmbledhen në zbatimin e Kodit të Etikës, respektimin e mos-cenimin e pavarësisë editoriale, prezumimin e pafajësisë, qëndrimin ndaj figurave të regjimit komunist e ndaj filmografisë së kohës së diktaturës.

Nuk kanë mbetur jashtë vëmendjes edhe çështje të njohura, por gjithnjë të diskutueshme të fushës së etikës e të gjuhës televizive. Të tilla janë respektimi i privatësisë së individit e i të drejtës së publikut për informim, raportet estetike-etike në programet argëtuese ose info-argëtuese, dëmtimi e deformimi i shqipes dhe cenimi i dinjitetit të shikuesve, si pasojë e keqpërdorimit e vulgaritetit të gjuhës, mbrojtja e të drejtave dhe e shëndetit mendor e moral të të miturve e adoleshentëve.

Ka ende raste kur me gjithë ndërhyrjen e përsëritur nga KKRT dhe Këshilli i Etikës, shkelet e drejta e prezumimit të pafajësisë për të dyshuarit, nga disa media të rëndësishme, e nxitur kryesisht edhe nga organet e rendit. KKRT, në forma të ndryshme, administrative e mediatike, ka bërë prezente për operatorët radiotelevizivë përvojën e institucioneve homologe të vendeve të tjera si dhe legjislacionin e ri të Këshillit të Evropës në këtë fushë, që materializohet kryesisht në Direktivën e Re të KE-së për Shërbimin e Mediave Audio Vizuale apo Rekomandimet e Deklaratës së Këshillit të Evropës mbi përgatitjen e informacionit në media, në lidhje me veprimet kriminale, ku i bëhet thirrje transmetuesve:

“Të respektojnë dinjitetin, të drejtën e privatësisë së viktimave, paditësve, të dyshuarve, të akuzuarve, personave të dënuar dhe dëshmitarëve, ashtu si dhe të familjeve të tyre, me përjashtim të rasteve kur informacioni është i një interesi publik”.

Problemet e sipërpërmendura nuk kanë qenë vetëm objekt i mbyllur i mbledhjeve e diskutimeve në Këshillin e Etikës, por janë bërë çështje edhe të veprimtarisë së përditshme të operatorëve radiotelevizivë, të Shoqatave të mediave, të opinionistëve të njohur në shtypin e shkruar, duke sensibilizuar kështu opinionin publik.

Një dukuri që, veç të tjerash është edhe etike, është bërë më së shumti e pranishme dhe ka tendencën të bëhet një ngërç i strukturës programore në shumicën e operatorëve televizivë, është ajo e mbingarkesës me programe informative, sidomos e debateve e komenteve politike, në raport me pjesën tjetër të programacionit. Teleshikuesit “bombardohen” me këto lloj programesh uniforme që, për fat të keq, shpesh herë përfundojnë me “sherre” mediatike banale, jashtë normave të etikës së komunikimit.

Vihet re se denduria e programeve të tilla, që transmetohen në fasha orare nga më të ndjekurat, në dy tre ekrane njëherësh, dëmtojnë emisionet e programet e tjera, të cilat si rregull ofrojnë më shumë edukim, argëtim, çlodhje e komunikim të drejtpërdrejtë me të gjitha kategoritë e shikuesve.

KKRT po studion mundësinë e bashkëpunimit me operatorët, për miratimin e rregullave që reduktojnë transmetimin e programeve të aktualitetit në “prime time”, sidomos tek transmetuesit kombëtarë.

Këshilli i Etikës dhe KKRT, gjatë vitit të kaluar, i kanë kushtuar gjithashtu vëmendje të veçantë ruajtjes e zbatimit të ligjit e të standardeve etike në edicionet informative. Janë të shumta e të vazhdueshme komunikimet shkresore, verbale e institucionale me disa operatorë televizivë dhe me organet e ruajtjes së Rendit Publik për respektimin e privatësisë së personave të dyshuar.

E njëjta mund të thuhet edhe për bashkëpunimin me institucione dhe shoqatat përkatëse, në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve e të adoleshentëve, të personave me aftësi të kufizuara, për të drejtat e njeriut, respektimin e të drejtës për përgënjeshtimin, etj.

Mbetet detyrë parësore që, në fushën e etikës së programeve televizive, aktet e kodet e secilit operator të respektojnë norma etiko-morale tradicionale e bashkëkohore të shoqërisë shqiptare, duke u azhornuar edhe me rekomandimet e përvojën evropiane përkatëse. KKRT ka në pikësynimet e veta bashkëpunimin me operatorët radiotelevizivë dhe gjithë aktorët e interesuar, në lidhje me gjetjen e rrugëve, apo përcaktimin e mjeteve ligjore për respektimin e rregullave në fushë të etikës në media. KKRT po harton një rregullore të veçantë dhe të

detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë operatorët, në lidhje me përdorimin e sinjalistikës në programet televizive.

3.3 Programet në Radiotelevizionin Publik Shqiptar

Statusi i veçantë i RTSH-së, si i vetmi operator radio-televiziv publik kombëtar dhe konkurrenca tashmë disavjeçare me operatorët televizivë privatë kushtëzojnë edhe situatën programore, edhe dukuritë, veçoritë e cilësinë e strukturës, apo përmbajtjes së programeve që transmeton. Ristrukturimi i kësaj strukture, i nisur që në vitin 2007, u shtri me një kahe pozitive edhe në vitin 2008. Jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe si vetëdijesim i potencialit krijues, edukues, informativ dhe argëtues, në shërbim të interesave të publikut, programet në operatorin publik kombëtar kanë rritje në shumëllojshmëri, në përmbajtje e në cilësi, duke u përpjekur, por ende me ritme të ngadalta, të përballojë garën me transmetuesit komercialë, që zotërojnë pjesën më të madhe të tregut radioteleviziv.

Për RTSH-në mund të thuhet se është nga të paktët operatorë radiotelevizivë në Shqipëri, ku pjesën më të madhe të transmetimeve, rreth 80 % e zënë programet e prodhuara vetë ose në bashkëprodhim. Këtu nuk është çështja vetëm te shifrat, por edhe te lloji i programeve që prodhohen e transmetohen në RTSH. Jo vetëm si rezultat i traditës, por edhe i aftësive profesionale, TVSH mbetet ende i vetmi operator që prodhon dhe transmeton filma artistikë dhe telenovela. Në këtë drejtim shembull domethënës është realizimi i filmit me 10 seri, "Dhimbe dashurie", i ndjekur nga një audiencë e madhe teleshikuesish, por edhe mjaft filma dokumentarë për ngjarje, figura e veprimtari që rezonojnë në historinë e kulturën tonë kombëtare. Tradita në prodhimin dhe transmetimin e filmave artistikë dhe dokumentarë nga TVSH duhet thelluar më tej.

Një vend të rëndësishëm në programacionin e RTSH-së vijon të zërë transmetimi i reportazheve televizivë dhe kronikave speciale me karakter hetues për probleme të mprehta aktuale, me ndikim të drejtpërdrejtë në grupime të gjera e të ndryshme të shoqërisë së sotme shqiptare.

Formatet e reja të disa emisioneve, fizionomia e rikonceptuar e strukturës programore, përmirësimi i vazhdueshëm i paraqitjes grafike, i faqosjes dhe promocionit, i kanë bërë programet e RTSH-së më tërheqëse e më dinamike se një vit më parë. Por duhet të theksojmë se mangësitë teknologjike të operatorit publik, ndikojnë edhe në cilësinë e programeve televizive, gjithmonë në krahasim me operatorët komercialë televizivë.

Operatori ynë i vetëm publik mbeti edhe gjatë vitit 2008, realizuesi më i mirë i emisioneve për moshat parashkollore dhe shkollore, në krahasim me transmetuesit komercialë. Kjo nuk do të thotë që fëmijët dhe të rinjtë gjetën atë që kërkonin në ekranin e TVSH-së. Mbetet ende shumë për të bërë, për të arritur

standardet e dëshiruara nga të vegjlit dhe të përcaktuara në dokumentet dhe direktivat evropiane në këtë drejtim.

Në ekranin e TVSH-së bëhet më shumë kujdes për respektimin e normave etike e standardit të gjuhës letrare kombëtare. Gjithnjë nëse e bëjmë krahasimin me mediat e tjera private. Por potenciali dhe detyrimi ligjor i tij në këtë fushë është shumë më i madh, sidomos në drejtim të nivelit, larmisë e cilësisë së përmbajtjes së programeve për fëmijë, me synim kryesor edukimin e tyre qytetar e kombëtar, formimin e karakterit e të personalitetit.

Ndryshime strukturore dhe një konceptim e dinamikë më konkurruese janë vënë re gjatë vitit 2008 edhe në tre kanalet ku transmetohen programet e Radio Tiranës. Janë realizuar e transmetuar disa programe të suksesshme. Por, me gjithë shumëllojshmërinë tematike e realizimin e saktë profesional, mjaft gjini radiofonike apo emisione të veçanta duhen parë në raport me kërkesat bashkëkohore të publikut, sidomos më të rinjve, që aktualisht e gjejnë veten në programin e dytë të Radio Tiranës.

Ndërthurja e emisioneve info-kulturore e muzikore me ato që trajtojnë problematika të mprehta sociale, sidomos nga realiteti shqiptar, në fasha orare të zgjedhura me kujdes, do ta rriste interesin e dëgjuesve të Radios Publike. Kanali i tretë i Radios i kushtohet kryesisht emigrantëve, me objektiv kryesor informimin e shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut.

3.4 Monitorimi

Studio e Monitorimit në KKRT gjatë vitit të kaluar u kompletua me stafin e nevojshëm të specialistëve, për të përballuar detyra të rëndësishme që kanë të bëjnë me monitorimin e edicioneve informative të transmetuara kryesisht prej operatorëve kombëtarë, me ndjekjen e problemeve etiko morale në programet radiotelevizive, me evidentimin dhe ndjekjen e respektimit të të drejtave të transmetimit, me funksionimin sipas strukturave programore të miratuara, me respektimin e kushteve dhe kritereve për transmetimin e reklamave etj.

Gjatë vitit 2008 janë monitoruar rreth 1800 orë edicione informative të radiove dhe televizioneve, proces që ka shërbyer për hartimin e raporteve mujore të monitorimit dhe relacioneve në zbatim të ligjit. Vetëm për të zbatuar kërkesat e ligjit për luftën kundër piraterisë televizive janë monitoruar rreth 27 600 orë programe televizive të transmetuara.

Në funksion të studimit dhe evidentimit të problemeve etike dhe morale në programet e transmetuara janë parë dhe analizuar rreth 14 000 orë programe. Monitorimi i respektimit të kushteve të transmetimit të reklamave është realizuar kryesisht me sondazhe. Për funksionimin e mëtejshëm të studios së monitorimit del si detyrë kryesore rikonstruksioni dhe përshtatja e saj për monitorimin edhe të

programeve të transmetuara nëpërmjet rrjeteve numerike, si në periudhat e zakonshme ashtu edhe gjatë fushatave elektorale.

3.4.1 Monitorimi i emisioneve informative

KKRT, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga neni 7/2 i ligjit "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", gjatë vitit 2008 ka vazhduar të monitorojë edicionet e lajmeve të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë.

3.4.2 Dukuri të veçanta

Gjatë ushtrimit të detyrimit ligjor për monitorimin e edicioneve informative janë vënë re këto dukuri të veçanta:

Gjatë këtij viti është shtuar numri i emisioneve politike dhe atyre investigative që kanë në qendër debatin politik të ditës, veprimtarinë e institucioneve kryesore dhe partive politike në vend, ose subjektet dhe aktorët e ndryshëm politikë. Kjo ka bërë që të zvogëlohet shumë koha kushtuar emisioneve kulturore, argëtuese, ekranizimeve, spektakleve, etj.

Kështu për shembull mund të përmendim te televizioni "Klan" emisionin "Opinion", i cili transmetohet 4 herë në javë, televizioni "Top Channel" me emisionet "Shqip" dhe "Top Story", televizioni "Koha" me emisionet "60 minuta", "Fokus", dhe "Protagonisti", etj, emisione që mund të transmetohen në orët e vona të natës duke i lënë më shumë hapësirë "spektaklit", zhanër televiziv i mirëpritur prej publikut. Këtu nuk po përmendim televizionet tematike si "News 24", "Alsat", "Nesër TV" që në pjesën dominuese të strukturës së tyre programore kanë informacionin dhe emisionet e aktualitetit.

Për shkak se në muajin Janar '08 vazhdoi dhe u finalizua gara për licencën e tretë televizive kombëtare, nga KKRT vazhdoi monitorimi i edicioneve kryesore të lajmeve të "Top Channel".

Radio kombëtare "Radio 2+" është monitoruar me sondazhe, pasi ky operator radiofonik nuk aplikon edicione kryesore të plota lajmesh, dhe në të shumtën e rasteve mungon "sinkroni", element bazë i kronikës radiofonike.

3.4.3 Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet

Në televizionin publik "Televizioni Shqiptar" gjatë edicionit kryesor të lajmeve koha e plotë, e shprehur në përqindje, vënë në dispozicion për pasqyrimin e

veprimtarisë së institucioneve kryesore është për Presidentin 7.4%, Kryeministrin 24.6%, Qeverinë 19.2% dhe Parlamentin 10.8%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së partive politike paraqitet si më poshtë: për Partinë Demokratike 9.2%, Partia Socialiste 16.3%, Lëvizja Socialiste për Integrim 6.9% dhe Partia Demokristiane 1.5%. *Një informacion më të zgjeruar nga të dhënat e monitorimit e pasqyrojnë tabelat bashkëngjitur.*

Në radion publike "Radio Tirana" gjatë edicionit kryesor të lajmeve koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së institucioneve kryesore është si më poshtë: për Presidentin 9.8%, Kryeministrin 27.2%, Qeverinë 19.3% dhe Parlamentin 11.3%. Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së partive politike është për Partinë Demokratike 5.4%, Partinë Socialiste 17.4%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 4.9% dhe Partinë Republikane 1.3%. Në këto të dhëna nuk është pasqyruar muaji Janar '08, për shkaqe që janë shpjeguar në kapitullin "Dukuri të veçanta". *(Për më shumë informacion mbi monitorimin referoju tabelave bashkëngjitur).*

Është me interes të paraqesim në mënyrë tabelore të dhëna krahasuese me një vit më parë në lidhje me pasqyrimin nga RTSH të veprimtarive të institucioneve qeveritare dhe atyre politike, të dhëna të tjera të krahasueshme, si ato për problemet gjinore apo temën e lajmit:

TELEVIZIONI SHQIPTAR	2007	2008
PRESIDENTI	5.7 %	7.4 %
KRYEMINISTRI	18.5 %	24.6 %
QEVERIA	27.2 %	19.2 %
PARLAMENTI	10.5 %	10.8 %
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)	8.1 %	9.2 %
PARTIA SOCIALISTE (PS)	17.9 %	16.3 %
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)	5.2 %	6.9 %

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se në krahasim me një vit më parë, është rritur prania e Presidentit dhe Kryeministrit në ekranin e televizionit publik, është zvogëluar koha e vënë në dispozicion të qeverisë, ndërsa pasqyrimi i veprimtarive të partive politike ka mbetur në po të njëjtat shifra të përafërta. Të njëjtat përfundime mund të nxirren edhe për radio "Tiranën" nga tabela e mëposhtme:

RADIO TIRANA	2007	2008
PRESIDENTI	7.5 %	9.8 %
KRYEMINISTRI	16.5 %	27.2 %
QEVERIA	15.9 %	19.4 %
PARLAMENTI	13.1 %	11.3 %
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)	11.5 %	5.4 %

PARTIA SOCIALISTE (PS)	19.2 %	17.4 %
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)	6.2 %	4.9 %

Gruas, si aktore në politikë i është kushtuar nga TVSH e njëjta hapësirë kohore sa një vit më parë, ndërsa radio publike i ka dhënë një hapësirë kohore pothuajse 2 herë më të madhe se në vitin 2008.

RAPORTET KOHORE PËR GJININË		
RADIO / TELEVISION	2007	2008
TELEVIZIONI SHQIPTAR	8.41 %	8.72 %
RADIO TIRANA	5.97 %	10.43 %

Temat si Politika, Veprimtaria e Presidentit, e Qeverisë, e Parlamentit të marra së bashku kanë pësuar një rritje në ekranin e TVSH-së, ndërsa nuk kanë ndryshuar te Radio Tirana gjatë vitit 2008, në krahasim me vitin 2007.

RAPORTET KOHORE PËR TEMËN E LAJMIT		
RADIO / TELEVISION	2007	2008
TELEVIZIONI SHQIPTAR	32.62 %	44.19 %
RADIO TIRANA	46.36 %	45.26 %

Në televizionin kombëtar "Klan" gjatë edicionit kryesor të lajmeve koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së institucioneve kryesore është për Presidentin 5.7%, Kryeministrin 24.2%, Qeverinë 17.1% dhe Parlamentin 7.4%.

Koha e plotë vënë në dispozicion nga TV "Klan" për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është, për Partinë Demokratike 9.1%, Partinë Socialiste 18.7%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 8.6% dhe Partinë Republikane 3.8%. *(për më shumë informacion mund ti referoheni tabelave bashkëngjitur).*

Në televizionin kombëtar "Top Channel" gjatë edicionit kryesor të lajmeve koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së institucioneve kryesore është si më poshtë: për Presidentin 7.6%, Kryeministrin 13.5%, Qeverinë 14.7% dhe Parlamentin 10.9%.

Koha e plotë vënë në dispozicion nga "Top Channel" për pasqyrimin e veprimtarisë së partive politike është, për Partinë Demokratike 5.7%, Partinë Socialiste 30.1%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 9.5% dhe Partinë Republikane 2.1%. *(për më shumë informacion referoju tabelave bashkëngjitur).*

Në televizionin kombëtar "Arbëria" gjatë edicionit kryesor të lajmeve për periudhën e monitoruar, koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e

veprimtarisë së institucioneve kryesore është për Presidentin 7.2%, Kryeministrin 14.7%, Qeverinë 17.5% dhe Parlamentin 7.6%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së partive politike është për Partinë Demokratike 4.8%, Partinë Socialiste 24.5%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 10.4% dhe Partinë Demokristiane 3.3%.

Në radion kombëtare "Top Albania Radio" gjatë edicionit kryesor të lajmeve koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së institucioneve kryesore është, për Presidentin 7.4%, Kryeministri 13.2%, Qeveria 12.9% dhe Parlamenti 8.4%. Koha e plotë vënë në dispozicion nga Top Albania Radio, për pasqyrimin e veprimtarisë së partive politike është për Partinë Demokratike 5.9%, Partinë Socialiste 29.5%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 10.8% dhe Partinë Republikane 2.8%.

3.4.4 Raportet kohore për gjininë

Gruaja akoma dhe sot zë një vend jo shumë të rëndësishëm në edicionet e lajmeve. Pavarësisht ligjeve elektorale që parashikojnë pjesëmarrjen sa më të madhe të gruas në politikë, situata në ekranin e vogël vazhdon të jetë e njëjtë. Kjo duket fare mirë tek raportet kohore të "Aktorit Sinkron".

Po ti referohemi të gjithë operatorëve publik dhe kombëtarë, koha e shprehur në përqindje, që operatorët radiotelevizivë kombëtarë, vënë në dispozicion të grave është: "Televizioni Shqiptar" 8.7%, "Klan" 6.7%, televizioni "Top Channel" 6.9%, televizioni "Arbëria" 7.3%, "Radio Tirana" 10.4%, dhe "Top Albania Radio" 9.9% të kohës së përgjithshme për aktorët sinkron.

3.4.5 Raportet kohore për temën e lajmit

Në të gjitha radiot dhe televizionet publike dhe kombëtare tema të tilla si Politika, Veprimtaria e Presidentit, Veprimtaria e Qeverisë dhe Veprimtaria e Parlamentit zënë pjesën më të madhe të kohës gjatë edicioneve kryesore të lajmeve.

Koha, e shprehur në përqindje që vihet në dispozicion të këtyre temave të marra së bashku është më e madhe te radioja dhe televizioni publik dhe konkretisht "Televizioni Shqiptar" 44.2% dhe "Radio Tirana" 45.3%.

Te radiot dhe televizionet kombëtare kjo kohë zë te "Klan" 33.4%, "Top Channel" 25.4%, "Arbëria" 22.1% dhe "Top Albania Radio" 32.5% të kohës totale të lajmeve.

3.4.6 Mangësi të bazës ligjore

KKRT është përpjekur dhe e ka realizuar me profesionalizëm monitorimin e edicioneve kryesore të lajmeve, dukuri që vihet re edhe nga raportet mujore të prezantuar pranë institucioneve përkatëse, si detyrim ligjor i KKRT.

Pavarësisht kësaj KKRT është ndodhur përpara një “ngërçi” në lidhje me përfshirjen e kohës kushtuar Kryeministrit ose ministrave të Qeverisë në favor të partive të cilët ata përfaqësojnë, ndofta në ngjashmëri me trajtimin e këtij problemi në Kodin Zgjedhor, kur trajtohen problemet e monitorimit të medias elektronike gjatë fushatave zgjedhore.

Po t’i referohemi ligjit në fuqi që rregullon veprimtarinë radiotelevizive në Shqipëri, atje përcaktohet qartë vetëm detyrimi i KKRT për monitorimin e edicioneve informative të transmetuara nga radiot dhe televizionet kombëtare, por në asnjë nen nuk përcaktohet se në favor të kujt duhet të kalojë koha për pasqyrimin në radio dhe televizion të veprimtarisë së Kryeministrit ose Ministrave të veçantë.

Në Ligjin Nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH, neni 41, thuhet se lajmet dhe informacionet që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, i paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë e të paanshme, nxisin formimin e lirë të mendimeve dhe nuk i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare.

Por ligji nuk përmend dhe nuk përcakton, se cilat raporte kohore duhen respektuar nga operatorët radiotelevizivë në periudha që nuk kanë lidhje me fushatat zgjedhore.

Në periudhë zgjedhore, për çështjen e përkatësisë së kohës së Kryeministrit ose Ministrave të veçantë, në kodin zgjedhor përcaktohet se koha e pasqyrimin të veprimtarive qeveritare, që lidhen me fushatën zgjedhore, përfshihet në kohën e partisë së cilës i përket titullari i institucionit që zhvillon veprimtarinë. (*Ligji Nr. 10.019, datë 29.12.2008, Neni 81, pika 3; dhe Neni 84, pika 2b*).

Lind pyetja: “A mund të përcaktohet për analogji një detyrim i tillë i ngjashëm edhe për periudhat e zakonshme pa fushatë zgjedhore”?

Për t’u përgjigjur çështjes së mësipërme, pra për t’i dhënë zgjidhje dukurisë së keqpërdorimit të rezultateve të monitorimit nga politika, propozimi i KKRT-së është që koha e plotë dhënë partive politike të shumicës duke përfshirë veprimtarinë e qeverisë dhe të kryeministrit të jetë 20% apo 30% më shumë se koha e dhënë partive opozitare.

Kjo mund të bëhet duke marrë parasysh se veprimtaria e Kryeministrit dhe Ministrave jo gjithmonë lidhet me veprimtarinë politike në vend, si dhe për faktin se ka edhe praktika të tjera ligjore që aplikojnë një formë të tillë.

3.4.7 Monitorimi i reklamave

KKRT ka monitoruar zbatimin e kërkesave të ligjit në transmetimin e reklamave nga ana e operatorëve radiotelevizivë. Për sa i përket radiove dhe televizioneve vendore po bëhen përpjekje që edhe ato të jenë nën vëzhgimin e KKRT-së në lidhje me transmetimin e reklamave në përputhje me ligjin.

3.4.8 Ngjarje të ndodhura

KKRT vëren se një formë e re transmetimit të publicitetit, ose siç njihet ndryshe "vendosja e produktit", po shfaqet në ekranet e televizioneve private. Vendosja e produktit është çdo formë e reklamës/publicitetit që konsiston në përfshirjen, referimin ose përmendjen e një produkti, shërbimi ose marke tregtare, që shfaqet brenda një programi, përkundërt pagesës ose shpërblimi të ngjashëm.

Të tilla raste ka pasur në televizionet "Top Channel" në emisionin "E Diell", në televizionin "Klan" në emisionin "E Diela Shqiptare" dhe në emisionin dedikuar fëmijëve "Superbilli", në televizionin "Vizion Plus" në emisionin "Zonë e Lirë", në televizionin "Ora News" gjatë intervistave me të ftuarit në studio, etj.

KKRT ka reaguar menjëherë nëpërmjet paralajmërimeve të bëra subjekteve përkatëse por pavarësisht përmirësimeve që vihen re për një periudhë kohe, përsëri duhet thënë që kjo formë transmetimi e publicitetit është akoma e pranishme në ekranet tona, pa u parashikuar ende në ligj. Edhe nëse do ti referohemi Direktivës AVMS, vendosja e produkteve është e pranueshme vetëm në veprat kinematografike, filmat dhe serialet, programet sportive dhe gjatë programeve të thjeshta argëtuese, për sa kohë që një shtet anëtar të vendosë ndryshe. Vendosja e produkteve nuk aplikohet në programet e fëmijëve, në edicionet informative dhe nuk duhet të ndikojë në pavarësinë editoriale të programeve.

Një dukuri tjetër e vërejtur gjatë vitit 2008, ka qenë edhe transmetimi i reklamave të porositura prej partive apo shoqatave politike. Rasti më përfaqësues i kësaj dukurie ka qenë transmetimi i reklamës me përmbajtje politike, porositur nga Grupimi Politik G 99. Kjo reklamë u transmetua nga televizioni "News 24", edhe pas paralajmërimit nga autoriteti rregullator. Përballë kësaj situatë KKRT vendosi sanksionin e gjobës të parashikuar me ligj për televizionin "News 24", sanksion i kontestuar si nga operatori përgjegjës, ashtu edhe nga segmente të politikës.

KKRT ka zbatuar kërkesat e nenit 55, pika 8 të ligjit nr. 8410 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH", ku saktësohet se: "nuk lejohet të transmetohen në radio dhe televizion, reklamat e partive ose shoqatave politike, përveç rasteve të parashikuara në ligjet elektorale".

Pra, në ligj mungon përcaktimi i reklamës politike, por përmendet porositësi i reklamës. Kjo ka sjellë edhe keqkuptime ose keq interpretime si nga ana e operatorëve të ndryshëm radioteleviziv, ashtu edhe subjekteve politike. Ligji ka nevojë të jap përkufizim të qartë për "reklamën politike", e njëkohësisht të përcaktojë kushtet për transmetimin e tyre nga media elektronike. Po me anë të dispozitave ligjore, është e domosdoshme të rregullohet edhe transmetimi i spoteve televizive të porositura nga institucionet qeveritare.

Një dukuri shqetësuese që duam ta përmendim në fushën e programacionit, ka qenë edhe përfshirja e reklamave indirekte, gjatë transmetimit të edicionit të lajmeve në televizion. Ato në përgjithësi jepen në formën e një kronike duke promovuar një biznes ose një produkt të ri, por që nga specialistët e KKRT-së janë gjykuar si reklama të fshehta ose të tërthorta, që bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. Mënjanimi i kësaj dukurie do të jetë në objektivat e KKRT-së gjatë vitit 2009.

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE

PËR EDICIONET INFORMATIVE

Koha e **Plotë** për Subjektet Politike (*koha në minuta*)

Janar - Dhjetor 2008

Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		356.77	195.96	221.85	77.85	210.48	67.86
KRYEMINISTRI		1185.02	830.69	394.57	159.46	583.45	121.08
QEVERIA		921.64	587.45	428.04	189.78	415.67	118.20
PARLAMENTI		518.90	254.25	319.69	82.76	242.95	76.93
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)							
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		443.75	311.74	166.78	52.70	116.80	54.27
PARTIA SOCIALISTE (PS)							
PARTIA SOCIALISTE (PS)		785.90	643.87	879.26	266.10	373.36	269.91
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)							
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		22.66	24.40	13.54	12.47	12.70	12.58
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)							
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)		329.83	296.43	277.85	112.83	104.90	98.85
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)							
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)		0.78	3.34	0.00	0.38	0.00	0.52
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)							
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		9.80	2.28	1.91	0.42	0.70	2.47
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)							
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		8.26	12.77	22.74	5.52	2.71	4.12
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)							
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)		27.44	29.36	12.82	20.70	10.74	14.72
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)							
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		12.49	6.93	2.49	4.27	7.42	2.82
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)							
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		73.06	60.85	34.90	35.33	21.17	17.21
PARTIA REPUBLIKANE (PR)							
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		61.80	131.57	59.98	32.07	28.84	26.12
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)							
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		19.32	31.02	41.94	17.09	8.54	14.87
PARTI TË TJERA							
PARTI TË TJERA		33.32	16.07	38.88	16.23	7.48	11.69
SHUMA							
SHUMA		4810.74	3438.98	2917.24	1085.96	2147.91	914.22

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

**RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE
PËR EDICIONET INFORMATIVE**

Koha e **Plotë** për Subjektet Politike (*koha në %*)

Janar - Dhjetor 2008

Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		7.42%	5.70%	7.60%	7.17%	9.80%	7.42%
KRYEMINISTRI		24.63%	24.16%	13.53%	14.68%	27.16%	13.24%
QEVERIA		19.16%	17.08%	14.67%	17.48%	19.35%	12.93%
PARLAMENTI		10.79%	7.39%	10.96%	7.62%	11.31%	8.41%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		9.22%	9.06%	5.72%	4.85%	5.44%	5.94%
PARTIA SOCIALISTE (PS)		16.34%	18.72%	30.14%	24.50%	17.38%	29.52%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0.47%	0.71%	0.46%	1.15%	0.59%	1.38%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)		6.86%	8.62%	9.52%	10.39%	4.88%	10.81%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)		0.02%	0.10%	0.00%	0.03%	0.00%	0.06%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0.20%	0.07%	0.07%	0.04%	0.03%	0.27%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		0.17%	0.37%	0.78%	0.51%	0.13%	0.45%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)		0.57%	0.85%	0.44%	1.91%	0.50%	1.61%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		0.26%	0.20%	0.09%	0.39%	0.35%	0.31%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		1.52%	1.77%	1.20%	3.25%	0.99%	1.88%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		1.28%	3.83%	2.06%	2.95%	1.34%	2.86%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		0.40%	0.90%	1.44%	1.57%	0.40%	1.63%
PARTI TË TJERA		0.69%	0.47%	1.33%	1.49%	0.35%	1.28%
SHUMA		100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE							
PËR EDICIONET INFORMATIVE							
Koha Sinkron për Subjektet Politike (<i>koha në minuta</i>)							
Janar - Dhjetor 2008							
Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		97.62	67.67	84.03	51.81	59.59	31.32
KRYEMINISTRI		518.04	379.40	174.78	172.84	220.06	66.26
QEVERIA		427.23	236.02	186.82	152.84	155.62	71.26
PARLAMENTI		93.52	35.40	34.77	33.68	41.73	20.50
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)							
		264.58	171.96	87.10	64.16	60.72	33.73
PARTIA SOCIALISTE (PS)							
		389.13	302.86	461.88	234.92	194.63	163.29
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)							
		13.11	11.67	7.70	9.70	6.84	7.84
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)							
		145.42	144.30	148.99	93.51	50.50	55.49
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)							
		0.37	1.23	0.00	0.13	0.00	0.20
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)							
		5.80	1.12	1.51	0.84	0.42	1.28
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)							
		4.93	6.60	10.93	3.74	1.31	2.10
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)							
		12.27	17.54	7.02	14.62	5.16	9.34
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)							
		5.21	3.05	1.09	3.48	2.41	1.56
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)							
		27.46	22.38	14.25	16.24	8.96	9.64
PARTIA REPUBLIKANE (PR)							
		31.06	65.09	28.56	20.12	12.72	16.23
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)							
		9.16	16.06	23.22	10.61	4.42	9.69
PARTI TË TJERA							
		14.11	7.16	16.74	10.06	3.12	6.50
SHUMA							
		2059.02	1489.51	1289.39	893.30	828.21	506.23

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE

PËR EDICIONET INFORMATIVE

Koha **Sinkron** për Subjektet Politike (*koha në minuta*)

Janar - Dhjetor 2008

Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		4.74%	4.54%	6.52%	5.80%	7.20%	6.19%
KRYEMINISTRI		25.16%	25.47%	13.56%	19.35%	26.57%	13.09%
QEVERIA		20.75%	15.85%	14.49%	17.11%	18.79%	14.08%
PARLAMENTI		4.54%	2.38%	2.70%	3.77%	5.04%	4.05%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)							
		12.85%	11.54%	6.76%	7.18%	7.33%	6.66%
PARTIA SOCIALISTE (PS)							
		18.90%	20.33%	35.62%	26.30%	23.50%	32.26%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)							
		0.64%	0.78%	0.60%	1.09%	0.83%	1.55%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)							
		7.06%	9.69%	11.56%	10.47%	6.10%	10.96%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)							
		0.02%	0.08%	0.00%	0.01%	0.00%	0.04%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)							
		0.28%	0.08%	0.12%	0.09%	0.05%	0.25%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)							
		0.24%	0.44%	0.85%	0.42%	0.16%	0.41%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)							
		0.60%	1.18%	0.54%	1.64%	0.62%	1.85%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)							
		0.25%	0.20%	0.08%	0.39%	0.29%	0.31%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)							
		1.33%	1.50%	1.11%	1.82%	1.08%	1.90%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)							
		1.51%	4.37%	2.22%	2.25%	1.54%	3.21%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)							
		0.44%	1.08%	1.80%	1.19%	0.53%	1.91%
PARTI TË TJERA							
		0.69%	0.48%	1.30%	1.13%	0.38%	1.28%
SHUMA							
		100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE

PËR EDICIONET INFORMATIVE

Koha **Sinkron** për Aktorët Politikë (*koha në minuta dhe %*)

Janar - Dhjetor 2008

Aktori Politik	TVSH	
	Min	%
Bamir Topi	97.08	4.76%
Sali Berisha	593.35	29.09%
Jozefina Topalli	95.56	4.68%
Edi Rama	213.73	10.48%
Aktorë të Tjerë	1,040.33	51.00%
Shuma	2,040.05	100.00%

Aktori Politik	TV KLAN	
	Min	%
Bamir Topi	66.95	4.57%
Sali Berisha	419.80	28.64%
Jozefina Topalli	32.12	2.19%
Edi Rama	167.53	11.43%
Aktorë të Tjerë	779.39	53.17%
Shuma	1,465.79	100.00%

Aktori Politik	TCH	
	Min	%
Bamir Topi	84.20	6.52%
Sali Berisha	194.18	15.03%
Jozefina Topalli	26.96	2.09%
Edi Rama	239.39	18.53%
Aktorë të Tjerë	746.88	57.83%
Shuma	1,291.61	100.00%

Aktori Politik	TVA	
	Min	%
Bamir Topi	29.18	5.47%
Sali Berisha	74.50	13.98%
Jozefina Topalli	12.98	2.44%
Edi Rama	53.27	9.99%
Aktorë të Tjerë	363.04	68.12%
Shuma	532.97	100.00%

Aktori Politik	R. TIRANA	
	Min	%
Bamir Topi	60.74	7.41%
Sali Berisha	227.02	27.69%
Jozefina Topalli	41.46	5.06%
Edi Rama	97.20	11.86%
Aktorë të Tjerë	393.34	47.98%
Shuma	819.76	100.00%

Aktori Politik	TAR	
	Min	%
Bamir Topi	30.89	6.18%
Sali Berisha	71.25	14.26%
Jozefina Topalli	17.38	3.48%
Edi Rama	68.53	13.71%
Aktorë të Tjerë	311.71	62.37%
Shuma	499.76	100.00%

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

<p align="center">RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE</p> <p align="center">PËR EDICIONET INFORMATIVE</p> <p align="center">Koha e Plotë për Temën e Lajmit (<i>koha në minuta</i>)</p> <p align="right">Janar - Dhjetor 2008</p>						
TEMA \ OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
01.POLITIKA	2300.74	2391.09	2031.26	663.05	1104.15	676.87
02.VEPRIMTARIA E PRESIDENTIT	284.60	125.23	83.62	30.32	140.02	33.56
03.VEPRIMTARIA E QEVERISË	1726.52	797.03	276.53	130.61	578.67	112.28
04.VEPRIMTARIA E PARLAMENTIT	635.34	367.26	435.72	108.14	306.59	125.79
05.VEPRIMTARIA E QEVERISË VENDORE	126.61	146.13	107.10	36.34	44.90	18.99
06.VEPRIMTARIA E DREJTËSISË	235.76	447.63	738.07	115.37	116.35	94.82
07.SOCIALE	2202.27	1191.06	1235.45	680.47	665.47	510.13
08.EKONOMI	529.62	767.34	785.33	113.57	252.29	77.05
09.KRONIKA E ZEZË / RENDI	223.56	696.04	700.60	319.46	130.65	168.53
10.LAJME NGA KOSOVA / RAJONI	886.76	956.43	1526.31	682.61	490.08	452.23
11.LAJME NDËRKOMBËTARE	438.95	1054.51	1569.79	760.79	437.37	356.22
12.ART / KULTURË	877.43	660.22	641.60	193.96	212.77	29.89
13.SPORT	542.56	1021.75	780.87	369.69	172.01	120.91
14.TË TJERA	182.45	314.22	211.90	19.24	53.98	145.03
SHUMA	11,193.17	10,935.94	11,124.15	4,223.62	4,705.30	2,922.30

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE

PËR EDICIONET INFORMATIVE

Koha e **Plotë** për Temën e Lajmit (*koha në %*)

Janar - Dhjetor 2008

TEMA \ OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	TV ARBERIA	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
01.POLITIKA	20.55%	21.86%	18.26%	15.70%	23.47%	23.16%
02.VEPRIMTARIA E PRESIDENTIT	2.54%	1.15%	0.75%	0.72%	2.98%	1.15%
03.VEPRIMTARIA E QEVERISË	15.42%	7.29%	2.49%	3.09%	12.30%	3.84%
04.VEPRIMTARIA E PARLAMENTIT	5.68%	3.36%	3.92%	2.56%	6.52%	4.30%
05.VEPRIMTARIA E QEVERISË VENDORE	1.13%	1.34%	0.96%	0.86%	0.95%	0.65%
06.VEPRIMTARIA E DREJTËSISË	2.11%	4.09%	6.63%	2.73%	2.47%	3.24%
07.SOCIALE	19.68%	10.89%	11.11%	16.11%	14.14%	17.46%
08.EKONOMI	4.73%	7.02%	7.06%	2.69%	5.36%	2.64%
09.KRONIKA E ZEZË / RENDI	2.00%	6.36%	6.30%	7.56%	2.78%	5.77%
10.LAJME NGA KOSOVA / RAJONI	7.92%	8.75%	13.72%	16.16%	10.42%	15.48%
11.LAJME NDËRKOMBËTARE	3.92%	9.64%	14.11%	18.01%	9.30%	12.19%
12.ART / KULTURË	7.84%	6.04%	5.77%	4.59%	4.52%	1.02%
13.SPORT	4.85%	9.34%	7.02%	8.75%	3.66%	4.14%
14.TË TJERA	1.63%	2.87%	1.90%	0.46%	1.15%	4.96%
SHUMA	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

4 RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

Në varësi të KKRT, Drejtoria Teknike rregullon transmetimet radio dhe televizive në territorin e Shqipërisë nga pikëpamja e administrimit të frekuencave, cilësisë së mbulimit me sinjal, kompatibilitetit elektromagnetik dhe mbrojtjen nga rrezatimet e dëmshme. Ajo siguron disponueshmërinë e frekuencave dhe funksionimin pa interferenca të transmetimeve radio e televizive.

Drejtoria Teknike koordinon frekuencat për transmetime radio e televizive me vendet fqinje dhe zbaton procedurat e modifikimit të planeve e notifikimit të frekuencave radiotevizive në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave, (ITU Gjenevë). Drejtoria Teknike monitoron cilësinë e mbulimit me sinjal të zonave të licencimit të operatorëve radio e televizivë.

Administrimi i frekuencave është një proces kompleks që përfshin inxhinierinë e rrjeteve, planifikimin e frekuencave, dhënien në përdorim dhe monitorimin e përdorimit.

4.1 Planifikimi i rrjeteve numerike

4.1.1 Klasifikimi i operatorëve të rrjeteve numerike

Implementimi i Planit të Frekuencave Numerike, që do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve numerike, kërkon klasifikimin e operatorëve që do të licencohen për të ndërtuar rrjetet numerikë.

Duke qenë se në ligj përcaktohen 3 kategori operatorësh (vendorë, rajonalë, kombëtarë), KKRT u përqendrua në përcaktimin e zonave të licencimit për operatorët vendorë dhe rajonalë, për të siguruar shfrytëzimin maksimal të brezave frekuencorë që përmban Plani, duke bërë kujdes për mbulimin e zonave me interesa të përbashkëta të traditës, sociale, ekonomike, etj dhe duke respektuar (për sa është e mundur) ndarjen administrative.

4.1.1.1 Njësitë e licencimit që mund të krijohen për DVB-T

Në planin numerik të frekuencave madhësia e allotmentit për banda të ndryshme është e ndryshme (shih fig. 1)

Në **UHF** madhësia e allotmentit mund të përafrohet me madhësinë e një qarku). Në këtë rast, për të arritur një shfrytëzim optimal të frekuencave, njësia më e vogël e licencimit (lokale) duhet të jetë në madhësinë e një qarku.

Në brezin UHF zona Tiranë-Durrës (2 qarqe) përfshihet në një allotment dhe për pasojë, për të njëjtën arsye (shfrytëzim maksimal i brezit të frekuencave), kjo zonë duhet të licencohet si një njësi.

Për qytetin e Tiranës, është parashikuar një njësi më e vogël licencimi (qyteti i Tiranës) që do të mbulohet nga SFN e sub-allotmentit të Tiranës.

Në VHF madhësia e allotmentit është më e madhe. Në këtë rast janë një allotment: qarqet Shkodër dhe Kukës, qarqet Tiranë dhe Fier dhe qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Allotmentet e tjera janë të njëjta me allotmentet në UHF.

1. Për DVB-T në UHF 2. Për DVB-T në VHF 3. Për T-DAB në VHF





Fig. 1 Forma e Allotmenteve

11 Allotmente

8 Allotmente

2 Allotmente

4.1.1.2 Njësitë e licencimit që mund të krijohen për T- DAB



Sub-Allotmenti i Tiranës

Sub-Allotmenti i Tiranës¹²

Njësitë e licencimit që mund të krijohen për T- DAB

Vetëm në VHF janë parashikuar dy allotmente (Veri dhe Jug)

4.1.2 Operatorët kombëtarë

Mbështetur në karakteristikat e planit të frekuencave të përshkruara më sipër, KKRT propozon që operatorët e rrjeteve numerike shqiptarë të klasifikohen si më poshtë.

4.1.2.1 Rrjete të operatorit publik Televizioni publik

Do të ndërtohen 2 rrjete numerike të operatorit publik. Ky numër përcaktohet nga ligji nr. 9742, i datës 28.05.2007 "Mbi transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë". KKRT është e detyruar t'i përmbahet këtij përcaktimi, ndonëse ka rezerva lidhur me shpenzimet relativisht të konsiderueshme për ndërtimin e dy rrjeteve kombëtare me fonde publike dhe kompletimin e tyre me programe pa pagesë të operatorit publik.

4.1.2.2 Rrjete të operatorëve privatë Operatorët kombëtarë

Kombinimi i 11 rrjeteve SFN të ndërtuar në secilin prej allotmenteve të planit numerik shqiptar për të mbështetur një multipleks kombëtar, do të operohet prej një operatori Kombëtar. Sipas ligjit në fuqi, kjo kategori operatorësh do të mbulojë mbi 80 % të territorit të banuar të Republikës.

Përcaktimi i numrit të përshtatshëm të rrjeteve kombëtarë bëhet mbështetur në kriteret ekonomike, sociale, kulturore, etj.

¹² Allotment: Zona qëmbulon një rrjet transmetimi me disa transmetues. Në rastin kur nr i transmetuesve është 1, allotmenti është zona që mbulohet nga një Caktim frekuencor (assignement)

Bazuar në rezervat e Planit të Frekuencave Numerike, kërkesat aktuale dhe nevojat e perspektivës, KKRT propozon që numri i rrjeteve kombëtare të jetë:

Rrjete të operatorit publik

Do të ndërtohen 2 rrjete numerike të operatorit publik. Ky numër përcaktohet nga ligji nr. 9742, i datës 28.05.2007 "Mbi transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë". KKRT është e detyruar t'i përmbahet këtij përcaktimi, ndonëse ka rezerva lidhur me shpenzimet relativisht të konsiderueshme për ndërtimin e dy rrjeteve kombëtare me fonde publike dhe kompletimin e tyre me programe pa pagesë të operatorit publik.

Rrjete të operatorëve privatë

Përcaktimi i numrit të operatorëve privatë kombëtarë do të jetë rezultat i studimit të hollësishëm të tregut mediatik me dinamikën e pritshme të tij dhe me segmentimin e tij në:

- transmetime të hapura, ose pa pagesë, dhe
- transmetime të krijuara.

Sidoqoftë, duke marrë në konsideratë, investimet e kryera për ndërtimin e rrjeteve numerike informale ekzistues, KKRT gjykon që, për momentin, kërkesat për programe kombëtare private në Shqipëri mund të mbulohen më së miri nga tre rrjete numerike kombëtare, që mundësojnë mbështetjen e më shumë se 60 programeve private kombëtare (të hapur e të krijuar).

4.1.2.3 Operatorët rajonale

Mbështetur në kriterin e shfrytëzimit efektiv të spektrit, plani i frekuencave numerike për bandën VHF lejon mundësinë e ndërtimit të rrjeteve rajonale e për pasojë licencimin e operatorëve rajonalë në zonat:

- Shkodër-Kukës,
- Tiranë-Durrës-Fier dhe
- Vlorë-Gjirokastrë,

pasi në secilën nga këto zona mund të ndërtohet një rrjet SFN (shfrytëzohet vetëm 1 frekuencë për të mbuluar më shumë se një qark).

Krijimi i rrjeteve të tjerë rajonale mund të realizohet duke kombinuar rrjetet SFN të zonave:

- Lezhë+Dibër (Shfrytëzohen 2 frekuenca)
- Elbasan + Korçë, (Shfrytëzohen 2 frekuenca), ose
- Elbasan + Berat, (Shfrytëzohen 2 frekuenca),ose
- Elbasan + Korçë+Berat (Shfrytëzohen 3 frekuenca).

Shënim: Ekziston mundësia e krijimit të një rrjeti tjetër rajonal Tiranë – Durrës në bandën UHF (shih operatorët lokalë)

Përfundimisht, për krijimin e rrjeteve të operatorëve rajonalë mund të planifikohet mbulimi i realizuar kryesisht nga shfrytëzimi i frekuencave sipas allotmenteve të planit kombëtar të frekuencave numerike për bandën VHF, i kombinuar (aty ku lind nevoja) me frekuenca në UHF.

4.1.2.4 Operatorët lokalë

Operatorët lokalë do të mbështeten në rrjetet SFN të secilit allotment. Në UHF mund të krijohen 11 rrjete lokale, prej të cilëve 10 do të mbulojnë afërsisht nga 1 qark dhe i njëmbëdhjeti do të mbulojë zonën Tiranë-Durrës (2 qarqe). Rrjeti Tiranë–Durrës duhet të trajtohet si rrjet rajonal.

Në planin e frekuencave numerike ekziston rezerva për ndërtimin e 7 rrjeteve SFN për mbulimin e qytetit të Tiranës (sub-allotmenti i Tiranës). Në mënyrë të përmblodhur, llojet e rrjeteve lokale në Shqipëri do të jenë:

- Rrjet lokal që mbulon 1 qark, dhe
- Rrjet lokal që mbulon qytetin e Tiranës.

4.1.3 Tabela përmbljedhëse e operatorëve kombëtarë

Arsyetimet e realizuara në paragrafët paraardhës mund të paraqiten nga tabela e mëposhtme, që përbën edhe propozimin për klasifikimin e rrjeteve numerike tokësore që do të përdoret për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike në territorin e Republikës së Shqipërisë:

Nr.	Klasifikimi	Zona e mbulimit	Numri i mbulimeve të planit kombëtar të shfrytëzuara	Numri i rrjeteve SFN që mund të krijohen
1	Operatorë Kombëtarë Publikë	Territori i Republikës	2	2
2	Operatorë Kombëtarë Privatë	Territori i Republikës	3	3
3	Operator Rajonalë 1	Tiranë-Durrës - Fier	0.3	1
4	Operatorë Rajonalë 2	2 qarqe	0.7	4
5	Operatorë Vendorë	1 Qark	1	11
6	Operatorë të qytetit të Tiranës	Qyteti i Tiranës dhe rrethinat	1	7
7	Mbulim i rezervuar për te ardhmen		1	1 komb ose 11 lok
	Totali		8	28*

Shënim:

1. Pa llogaritur rrjetet që mund të krijohen nga mbulimi rezervë
2. Mbulimi kombëtar i mbetur mund të shfrytëzohet për ndërtimin e një rrjeti shtesë kombëtar ose për ndërtimin e operatorëve rajonalë me zonë mbulimi më shumë se dy qarqe.
3. Operatorët rajonale (Rajonal 1 dhe Rajonal 2) do të shfrytëzojnë bashkërisht bandën VHF (1 mbulim)

Në allotmentet ku plani numerik mundëson ndërtimin e më shumë se 8 rrjeteve (Kukës, Dibër, Tiranë, Fier, Berat, Korçë, Gjirokastër) mund të parashikohen kombinime për krijimin e rrjeteve shtesë lokale apo rajonale.

4.2 Përgatitja e dokumentacionit teknik për licencimin e rrjeteve numerike

Në kuadrin e hapjes së rrugës për implementimin e Planit Numerik, një punë shumë e specializuar dhe voluminoze është kryer për përgatitjen e dokumentacionit teknik për ndërtimin e rrjeteve numerike dhe hartimin e rregullores teknike.

4.2.1 Hartimi i planit të Caktimeve Frekuencore (Konvertimi i allotmenteve në Caktime)

Vënia në jetë e Planit të Frekuencave Numerike kërkon konvertimin e allotmenteve në Caktime Frekuencore (assignments). Me fjalë të tjera, kjo do të thotë të projektohen pikat e transmetimit dhe gjithë parametrat e stacioneve transmetues që do të mbulojnë me sinjal SFN (me frekuencë të vetme-single frequency network) territorin e secilit prej allotmenteve të paraqitur në figurën 1 (Forma e Allotmenteve).

Duke qenë se, për ndërtimin e rrjeteve numerike shqiptarë, është zgjedhur konfiguracioni RN2 me 3 transmetues kryesorë¹³, për secilin allotment u projektuan mesatarisht 3 pika transmetuese. Për të siguruar një mbulim sa më uniform të territorit, në disa raste për allotmente të veçantë janë projektuar më shumë se tre pika transmetimi, në varësi të shtrirjes së allotmentit, konfiguracionit të terrenit dhe shpërndarjes së popullsisë.

Më poshtë, për ilustrim, tregohet projektimi i pikave kryesore të transmetimit për ndërtimin e rrjetit numerik për mbulimin me sinjal të allotmentit të Tiranës (Zona Tiranë-Durrës).

¹³ Shih Raporti Vjetor 2007




Fig. 2 Skema e ndërtimit të rrjetit numerik SFN për mbulimin e rajonit Tiranë-Durrës

Siç demonstron nga skema e mësipërme rrjeti përbëhet nga pajisja qendrore, 3 Stacione Kryesore (të përcaktuara nga Tipi i Rrjetit Referencë i zgjedhur, RN 2) dhe sistemet r/rele që lidhin pajisjet qendrore me transmetuesit kryesorë.

Rrjeti i mësipërm siguron mbulimin e mbi 70% të territorit të rajonit Tiranë-Durrës me sinjal numerik të nivelit mbi 70 dB μ /m. Për mbulimin e pjesës së mbetur duhen planifikuar shpenzime shtesë për instalimin e 'Gap-filler-ëve' në zonat e mbetura pa u mbuluar nga transmetuesit kryesorë (Shih fig. 3 më poshtë).




Fig. 3 Mbulimi me sinjal numerik i rajonit Tiranë-Durrës

Një studim i ngjashëm u krye për secilin allotment. Përcaktimi i pikave kryesore të transmetimit u realizua pas një studimi të hollësishëm të gjendjes së pikave ekzistuese të transmetimit analog dhe karakteristikave të secilit allotment në veçanti. Studimi ka përcaktuar edhe pika të reja transmetimi, por vënia e tyre në funksionim do të paraqesë probleme, pasi në disa prej vendeve të identifikuara si optimale lidhur me përhapjen e sinjalit, mungon infrastruktura (rrugët, ambientet, furnizimi me energji, etj)

Pas përcaktimit të pikave të transmetimit u kryen llogaritjet përkatëse për të përcaktuar Fuqinë Efektive të Rrezatuar (ERP), diagramën e antenave dhe parametrat e tjerë të rrjeteve.

Në përfundim u arrit të përcaktoheshin parametrat e rrjeteve numerikë për mbulimin e Shqipërisë me sinjal numerik, bazuar në frekuencat e përcaktuara për Shqipërinë nga Marrëveshja GE- 06.





Fig. 4 Pikat kryesore të transmetimit numerik dhe diagramet e antenave

I



Vënia në punë e stacioneve transmetuese do të bëhet konform procedurave të nenit 5 të akteve finale të marrëveshjes GE-06.



KESHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE
TELEVIZIONIT
Departamenti Teknik

Fig. 5 Mbulimi me sinjal numerik i planifikuar të arrihet nga vënia në punë e pikave kryesore të transmetimit numerik

Figura e mësipërme (Fig. 5) pasqyron pikat kryesore të transmetimit numerik dhe diagramet e antenave të transmetuesve të projektuara për mbulimin me sinjal numerik të territorit të Shqipërisë. Sipas llogaritjeve, kjo skemë siguron mbulimin me sinjal të mbi 70 % të territorit të Shqipërisë ku jeton mbi 80% e popullsisë. Drejtoria Teknike po vazhdon punën për projektimin e "gap-filler-ëve për rritjen e territorit të mbuluar.

Dokumentacioni teknik i Caktimeve Frekuencore, i llogaritur siç u përshkrua më sipër dhe i formatuar në përputhje me specifikimet e notifikimit të BR (modeli GT1) është dërguar në Byronë e Radio-komunikacioneve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), për t'u përfshirë në Planin e Frekuencave Numerike dhe në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave. Regjistrimi i Caktimeve Frekuencore Numerike i hap rrugën ndërtimit të rrjeteve numerike në territorin e Shqipërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga marrëveshja GE- 06.

4.2.2 Miratimi i kushteve teknike të rrjeteve numerike dhe kushtet e tjera për Operatorët e Rrjeteve Numerike Tokësore

Në kuadrin e zbatimit të Vendimit të KKRT për shpalljen e konkurrimit të kandidatave për licencë për Operator Rrjeti Numerik Tokësor Privat Kombëtar, mbështetur në Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radio-komunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 430-862 MHz (Gjenevë 15 Maj -16 Qershor 2006) dhe materiale të tjera ndihmëse (Licencimi i Televizionit Numerik-Komisioni për Rregullimin e Komunikacioneve-Irlandë, Bazat e transmetimeve numerike, etj) u përgatitën karakteristikat teknike të Rrjeteve numerike tokësore shqiptare, të cilat duhet të zbatohen si kushte të licencës së Operatorit të Rrjetit Numerik. Këto kushte u miratuan me Vendimin nr. 731, dt. 29.09.2008 të KKRT-së.

Kushtet Teknike të ndërtimit të rrjeteve numerike, detajojnë karakteristikat e pajisjeve që duhet të përdoren për të ofruar një shërbim të kënaqshëm dhe të sigurt për publikun. Ato nuk përfshijnë specifikimet e detajuara të pajisjeve.

Këto kushte detajojnë gjithashtu karakteristikat kryesore për sigurimin e kompatibilitetit me përdorues të tjerë të autorizuar të spektrit të radio-frekuencave.

Parametrat e specifikuar në dokumentin e Kushteve teknike janë parametra të dhëna në dokumentet e IEC, ETSI:

ISO/IEC 13818-1, 2, 3, ISO/IEC 14496, EN 300

468, TR 101 211, TR 101 289, EN 301 192, EN 50221 dhe EN 300 472.

Kushtet e specifikuara në dokument do të jenë subjekt i ndryshimit kohë mbas kohe, në përputhje me zhvillimet teknologjike. Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë jepen çështjet kryesore që janë trajtuar në specifikimin e Kushteve Teknike:

1. Karakteristikat e Multipleksit DTT

- 1.1. Inxhinieria e sistemit
- 1.2. Konstruksioni i pajisjeve
- 1.3. Çertifikata e instalimit dhe mirëmbajtjes
- 1.4. Standardet e sistemit
- 1.5. Informacioni specifik i programeve
- 1.6. Informacioni i shërbimit
- 1.7. Kodet e informacionit të shërbimit
- 1.8. Përditësimi i software-it dhe inkriptimi
- 1.9. Shërbime transmetimi shtesë
- 1.10. Performanca e sistemit
- 1.11. Informacioni që paraqitet në KKRT
- 1.12. Kushtet për operimin e sistemeve të aksesit të kushtëzuar
- 1.13. Standardet e sistemeve të aksesit të kushtëzuar
- 1.14. Detyrimet e shërbimit për ofruesit e shërbimit të aksesit të kufizuar

2. Karakteristikat transmetuese DTT

- 2.1. Projektimi i sistemit
- 2.2. Standardet e sistemit
 - 2.2.1. Standardi i transmetimit
- 2.3. Lista përmbledhëse e parametrave
 - 2.3.1. Gjerësia e kanaleve të frekuencave dhe bandat e operimit
 - 2.3.2. Modulimi
 - 2.3.3. Përditësimet e software-ve
 - 2.3.4. Shërbimet shtesë të transmetimit
- 2.4. Performanca e sistemit
 - 2.4.1. Cilësia e mbulimit
 - 2.4.2. Stabiliteti i frekuencave
 - 2.4.3. Fuqia
 - 2.4.4. Nivelet maksimale të lejuara të emisioneve të spurieve

3. Zbatimi i Planit Kombëtar të Frekuencave

- 3.1. Kanalet e frekuencave dhe grupet standarde.
- 3.2. Lista e caktimeve
- 3.3. Parametrat e planifikimit
- 3.4. Intensiteti minimal i fushës
- 3.5. Çertifikimi i stacionit dhe mirëmbajtja
- 3.6. Caktimet shtesë dhe të modifikuara
- 3.7. Marrëveshjet ndërkombëtare
- 3.8. Informacioni që paraqitet në KKRT

4.2.3 Vendime të karakterit strategjik e rregullator

Në mungesë të Strategjisë së miratuar të zhvillimit të transmetimeve numerike, për të siguruar implementimin e rrjeteve numerike të teknologjisë më të përparuar, KKRT me të njëjtin vendim nr. 731, dt. 29.09.2008 adoptoi disa vendime të karakterit strategjik e rregullator lidhur me standardet dhe rregullat që duhet të zbatohen në ndërtimin e rrjeteve numerike:

Shfrytëzimi efektiv i spektrit

Për të siguruar shfrytëzimin efektiv të spektrit të frekuencave, si standard kodimi do të aplikohet **Standardi MPEG 4**, dhe standarde të tjerë më të avancuar që do të shfaqen në të ardhmen.

Sigurimi i cilësisë së transmetimit të programeve

Për të siguruar trajtim të barabartë të operatorëve të programeve që do të mbështeten në rrjetet numerike, aplikantët për licencë për ndërtimin e rrjeteve numerike duhet të angazhohen për sigurimin e shpejtësisë minimale (Bit Rate) të barabartë për secilin program sipas vlerave të përcaktuara në Karakteristikat Teknike. Me fjalë të tjera secilit prej operatorëve të programeve duhet t'u sigurohet cilësi e njëjtë transmetimi, përkundër praktikës që zbatohet aktualisht, ku cilësia e nevojshme për të transmetuar një ndeshje futbolli, për shembull sigurohet në kurriz të uljes së cilësisë së një programi tjetër që mbështetet në të njëjtin MUX, duke shfrytëzuar vetitë e multipleksit statistikor.

Sigurimi i pragut minimal të mbulimit

Përqindja e mbulimit të territorit të çdo allotmenti, në fazën e parë të ndërtimit, do të jetë përqindja e përcaktuar në dokumentet e aplikimit të përgatitura nga Drejtoria Teknike.

Fleksibiliteti në projektim

Ndonjë nga pikat e transmetimit të përcaktuara në dokumentet e aplikimit mund të ndryshojë me propozim të aplikantëve, të cilët eventualisht duhet të përgatitin argumentimin teknik për arsyetimin e nevojës së ndryshimit, duke respektuar parametrat e Planit Kombëtar të Frekuencave numerike. Duke qenë se këto ndryshime mund të propozohen gjatë përgatitjes së dokumentacionit për licencim, ato do t'u bëhen të ditura të gjithë pjesëmarrësve në garë.

Rregullimi i dokumentacionit për lehtësimin e kontrollit

Aplikantët, në projektin e rrjetit numerik, duhet të paraqesin edhe planimetritë e ambienteve të të gjitha pikave të transmetimit.

4.3 Puna për fillimin e vënies në jetë të planit numerik

4.3.1 Lirimi i frekuencave të zëna nga transmetimet analoge

Menjëherë pas përfundimit të Planit Numerik, KKRT organizoi punën për sigurimin e implementimit të këtij plani. Pas studimit të okupimit të spektrit nga transmetimet ekzistuese analoge dhe numerike, u përcaktuan frekuencat e lira në të gjithë territorin e vendit, që përkonin me Planin Numerik. Nga studimi rezultoi se me frekuencat e lira të identifikuara mund të ndërtohen tre rrjete numerike kombëtare. Përcaktuese në këtë konkluzion u bë gjendja e shfrytëzimit të frekuencave në pikën më të ngarkuar, që ishte pika transmetuese e malit të Dajtit. Nëse në këtë pikë do të lirohej spektri i zënë nga transmetimet analoge, do të rriteshin mundësitë për krijimin e rrjeteve të tjerë numerikë kombëtarë, rajonalë dhe lokalë.

Duke u nisur nga gjendja e përshkruar më sipër, për të kapërcyer informalitetin në transmetimet numerike ekzistuese të palicencuara, të rekomanduar nga Rezoluta e datës 20 Mars 2008 e Kuvendit të Shqipërisë, KKRT-ja, me Vendimin nr. 726 dt. 08.09.2008 vendosi shpalljen e garës për licencimin e 3 rrjeteve privatë kombëtarë, për të cilët Drejtoria Teknike përgatiti dokumentacionin përkatës.

Ligji në fuqi (Nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë" (neni 4, pika 2), përcakton:

"Radiotelevizioni shqiptar (RTSH) ka të drejtë të ngrëjë dy rrjete tokësorë numerikë kombëtarë duke përdorur frekuencat e Planit Numerik që do të përcaktohen nga KKRT. Transmetimet analoge të RTSH do të vazhdojnë gjatë gjithë periudhës së tranzicionit".

KKRT është duke finalizuar planin e Migrimit të frekuencave të okupuara analoge për t'i hapur rrugë zbatimit të plotë të planit numerik. Detyra prioritare e kësaj pune është përcaktimi i frekuencave të lira për përgatitjen e ndërtimit të rrjeteve numerike të operatorit publik (RTSH), që aktualisht ka kërkuar për këtë qëllim përcaktimin e kanaleve, duke filluar nga rajoni i Tiranës.

Bazuar në një vlerësim paraprak, për të siguruar zbatimin e plotë të Planit Kombëtar të Frekuencave Numerike do të duhet transferimi i rreth 45 stacioneve ekzistues analogë në frekuenca të tjera transmetimi. Duke qenë se, sipas ligjit të cituar më sipër (neni 3, pika 7):

"Në rastet kur, për implementimin e Planit të Frekuencave në koordinim me vendet fqinje, një frekuencë lëshuar një operatori të licencuar për transmetime analoge kërkohet për ngritjen e një rrjeti numerik, KKRT i lëshon operatorit analog një frekuencë tjetër për të mbuluar të njëjtin territor. Shpenzimet për ndryshimin e frekuencës përballohen nga KKRT-ja".

KKRT ka marrë masa për përballimin e kësaj detyre duke planifikuar në buxhetin për vitin 2008 fondet e nevojshme që do të përdoren për modifikimet teknike të stacioneve transmetues dhe për informimin e publikut. Po punohet për përcaktimin e modaliteteve të lëvritimit.

Për t'u paraprirë kërkesave, si të operatorit publik, ashtu edhe të operatorëve të tjerë privatë, KKRT ka filluar të zbatojë lirimin gradual të spektrit, duke filluar nga zona Tiranë – Durrës. Në këtë kontekst, me Vendimin nr. 730, të datës 29.09.2008, KKRT ka vendosur lirimin e kanalit 21 UHF nga transmetimet analoge të operatorit TELE 1 dhe kalimin e këtij programi në kanal 68 UHF, brenda datës 31.01.2009.

Fillimi i procedurës së Migrimit duke filluar nga kanali 21 (kanali i parë i brezit UHF) u propozua për të vendosur kriterin e renditjes si bazë për radhën e liritimit të spektrit, për të shmangur vërejtjet dhe kontestimet eventuale.

KKRT-ja ka vendosur që lirimi i spektrit të bëhet rast pas rasti sipas një kalendarit të përcaktuar në kohë.

4.4 Dividendi numerik

Kalimi i plotë në transmetimet numerike do të lirojë sasi të konsiderueshme spektri që sot përdoret për transmetime analoge. Organizmat botërore që rregullojnë sektorin e telekomunikacioneve kanë kohë që kanë studiuar dhe kanë propozuar mënyrat për shfrytëzimin e mëtejshëm të kësaj rezerve të paçmuar në dobi të shoqërisë dhe biznesit. Në Konferencën Botërore të Radio-Komunikacioneve (WRC07) që u mbajt në Tetor 2007 në Gjenevë, janë marrë disa vendime të rëndësishme mbi përdorimin e spektrit që do të lirohet, ose siç quhet ndryshe mbi "dividendin numerik". Edhe organizmat e specializuara evropiane po punojnë për të përcaktuar një politikë të përbashkët evropiane për planifikimin e shfrytëzimit të avantazheve të dividendit numerik.

Tashmë në disa vende të Evropës janë mbyllur transmetimet analoge, por shumë pak shtete kanë ndërtuar plane për përdorimin e frekuencave që do lirohen si rezultat i kësaj mbylljeje. Dividendi numerik është lirimi më i madh i spektrit që ka ndodhur për dekada të tëra, por për përdorimin e këtij spektri të liruuar janë ngritur shumë pyetje, që deri tani kanë mbetur pa përgjigje:

- Sa është sasia e spektrit që mund të disponohet?
- Cilat janë teknologjitë që do të përdoren?
- A duhet të shkojmë drejt krijimit të një modeli të harmonizuar të përdorimit të spektrit për të cilin ka bërë thirrje Komisioni Evropian?
- Cila është perspektiva që shohin politikanët për dividendin numerik?
- Sa vende do të ofrojnë HDTV tokësore?

- Cili do të jetë ndikimi i përdorimit të dispozitivave radio "cognitive" në "Hapësirën e bardhë" TV ?
- Si mund të mbrohen shërbimet e tjera UHF si mikrofonat pa tel dhe sektorin e sigurisë publike?

Hapat e parashikuara nga Komuniteti Evropian për të arritur në miratimin e nënndarjeve të spektrit të UHF për shfrytëzimin e harmonizuar të dividendit numerik në shkallë pan-evropiane, për vitin 2008 ishin:

<u>Prill 2008:</u>	Mandat i ri teknik për CEPT për organizimin e studimit.
<u>Maj 2008:</u>	Fillimi i studimit të vlerësimit të ndikimit (konsultime socio-ekonomike, legale, teknike).
<u>Qershor 2008:</u>	Konkluzionet e Këshillit.
<u>Mesi i 2008:</u>	Përcaktimi i pozicionit të Parlamentit Evropian.
<u>Fundi i 2008:</u>	Propozim i detajuar i Komisionit për mënyrën rregullatore.

Duke u nisur nga arritjet e vendeve të tjera jashtë Evropës (USA dhe Japonia) si dhe nga intensiteti i parashikuar nga Komisioni Evropian i masave për arritjen e një përdorimi të harmonizuar pan Evropian të dividendit numerik, edhe Shqipëria duhet të marrë masa për koordinimin e strategjisë së saj të zhvillimit të transmetimeve radio e televizive (dhe të telekomunikacioneve), me përpjekjet e vendeve të tjera për të arritur një rezultat optimal social-kulturor dhe ekonomik të këtij dividendi.

Bashkimi me përpjekjet Evropiane për përdorimin më optimal të spektrit do të kërkojë edhe harmonizimin e Planit Shqiptar të Frekuencave me planin e harmonizuar që do të prodhohet pas përfundimit të hapave të përshkruar më sipër. Duke qenë se sipas informacioneve paraprake, në brezin UHF janë përcaktuar tre nën-banda për 3 lloj shërbimesh të ndryshme, do të kërkohej që plani i frekuencave i miratuar në GE06 të modifikohet duke parashikuar transferimin e disa frekuencave në nën-bandat e caktuara për transmetime radiotevizive (analoge e numerike deri në 2012 dhe vetëm numerike pas 2012).

KKRT duke mbajtur kontakte dhe duke marrë informacion mbi zhvillimet më të reja në fushën e planifikimit të shfrytëzimit të dividendit numerik, është duke studiuar ndikimin e vendimeve që do të ndërmarrin vendet Evropiane që do të pasqyrohen edhe në vendime të CEPT-it (Konferenca Evropiane e Postave dhe e Telekomunikacioneve, ku aderon edhe Republika e Shqipërisë), në planin shqiptar të frekuencave numerike, ndryshimet që duhen bërë në këtë Plan dhe planifikimin e shërbimeve të reja që do të mundësojë shfrytëzimi i dividendit numerik (transmetimet TV mobile, transmetimet me definicion të lartë (HDTV) të mbështetura në rrjetet tokësore, etj.

Më poshtë jepet propozimi i bërë në nivel Evropian për ndarjen e re të spektrit 470-862 MHz që sot përdoret për transmetime televizive (analoge dhe numerike).




Fig. 6 Propozimi i ndarjes së re të spektrit

Rrjete unidireksionale
(Fuqi e vogël)

Rrjete

Rrjete bi-direksionale
(fuqi e ulët dhe e mesme)

Pjesa që përbën dividendin numerik aktual

4.5 Monitorimi

Gjatë vitit 2008 KKRT u përqendrua në mbajtjen e regjimit të vendosur të transmetimeve radio e televizive ekzistuese, si nëpërmjet organizimit të monitorimit periodik të programuar, ashtu edhe nëpërmjet inspektimeve të dedikuara në zona të veçanta, bazuar në informacionet e marra në rrugë të ndryshme (ankesa nga qytetarët dhe konkurrentët për cilësi të dobët sinjali, interferenca të shkaktuar nga kanale ekzistues apo të palicencuar, etj).

Në strukturën organike të administratës të KKRT-së tashmë sektori i monitorimit të frekuencave si pjesë e Drejtorisë Teknike, funksionon si njësi e kompletuar me personelin dhe pajisjet përkatëse. Për vitin 2008 veprimtaria e monitorimit është zhvilluar bazuar në një plan veprimi të miratuar nga titullari i KKRT që parashikonte inspektimin e shfrytëzimit të spektrit në gjithë territorin e Shqipërisë periodikisht, dy herë në vit.

Krahas inspektimit të planifikuar, për sinjalet radio e televizive që mund të kapen nga Tirana (kryesisht për sinjalet që mbulojnë hapësirën Tiranë-Durrës), është organizuar monitorimi ditor.

Të dhënat e monitorimit (periodik dhe ditor) regjistrohen në bazën e të dhënave të krijuar që tashmë jep një pasqyrë të detajuar të nivelit dhe cilësisë së sinjalit të

secilit nga transmetuesit e instaluar (për zonën Tiranë-Durrës përditë, për zonat e tjera, të paktën dy herë në vit, në kushte të ndryshme atmosferike).

Krijimi i bazës së të dhënave të monitorimit, duke lejuar krahasimin me të dhënat e regjistruara në bazën e të dhënave të planifikimit, ka lehtësuar punën për ruajtjen e regjimit të transmetimit të stacioneve të ndryshëm në përputhje me kushtet e licencës, duke parandaluar interferencat e dëmshme midis stacioneve.

Stabilizimi i monitorimit dhe përmirësimi i bashkëpunimit të KKRT-së me Policinë Tatimore, ka mundësuar edhe reagimin e shpejtë të KKRT në rastet kur janë konstatuar shkelje të kushteve të licencës, transmetime radiotelevizive të paautorizuara apo jashtë zonave të licencimit, etj.

Përmirësimet e nënvizuara më sipër, në kombinim me masat e marra vitin e kaluar për disiplinimin e transmetimeve radio e televizive, kanë ndikuar në uljen e ndjeshme të numrit të shkeljeve të regjistruara në vitin 2008 në krahasim me një vit më parë. Aktualisht, transmetimet jashtë zonës së licencimit, me pak përjashtime të evidentuara, nuk përbëjnë më shqetësimin serioz të një viti më parë.

Tashmë KKRT është fokusuar në zgjidhjen e problemeve të interferencave të shkaktuara nga rritja e paautorizuar e fuqisë së transmetimit nga disa operatorë, fenomen i përhapur sidomos në pikën e transmetimit në malin e Dajtit ku është dashur ndërhyrja e KKRT për të shmangur interferencat.

Gjatë vitit 2008 janë konstatuar disa raste të ndryshimit të paautorizuar të frekuencave apo edhe të ndryshimit të pikës së transmetimit nga operatorë të ndryshëm. Në të gjitha këto raste këtyre operatoreve u është dërguar njoftim me shkrim për shkeljet e konstatuara, duke i vënë gjithashtu në dijeni edhe për sanksionet që parashikon ligji Nr. 8410, datë 30. 09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë " për secilën nga shkeljet.

Për vitin 2009, janë përcaktuar masat për plotësimin e njësisë së monitorimit me disa pajisje që do të përmirësonin cilësinë dhe gamën e kontroleve si pajisje matëse të intensitetit të fushës për transmetimet numerike, matës fuqie, etj. Përmirësimi i mëtejshëm i efektivitetit të monitorimit do të kërkojë shtrirjen e monitorimit të përditshëm mbi gjithë territorin e vendit. KKRT ka përgatitur një projekt ide për realizimin e rrjetit të monitorimit të frekuencave dhe programeve që do të bëjë të mundur kontrollin e gjendjes nga qendra në Tiranë.

4.6 Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge

4.6.1 Televizioni publik

4.6.1.1 Programet

Radio Tirana transmeton dy programe radiofonike në shkallë vendi, si edhe një program të tretë në gjuhën shqipe për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Radio Tirana transmeton në valë të mesme dhe të shkurtra. Televizioni transmeton në një program televiziv, 24 orë në ditë. Gjithashtu RTSH-ja transmeton 17 orë në ditë program në një kanal satelitor për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Programi i dytë televiziv, i parashikuar nga ligji nr. 8410 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" vazhdon të mungojë.

4.6.1.2 Transmetimi

Aktualisht programet televizive dhe radiofonike të RTSH-së shpërndahen nëpërmjet rrjetit të transmetuesve tokësorë analogë në brezin e frekuencave UHF dhe VHF i cili mbulon thuajse të gjithë sipërfaqen e banuar të vendit (mbi 73 % të territorit). Për plotësimin e mbulimit përdoren 10 pika kryesore transmetuese dhe rreth 250 përsëritës. Një rrjet i transmetuesve radiofonikë analogë FM mbulon pjesën më të madhe të vendit (mbi 85 %).

Dy pika të fuqishme transmetuese me valë të shkurtra dhe të mesme përdoren për transmetimet radiofonike analoge AM jashtë shtetit. Ekziston një marrës – dhënës satelitor në Eutelsat W2 që transmeton programin televiziv dhe radio Tiranën. Transmetuesit tokësorë kryesorë të instaluar në 10 pikat e përmendura më sipër e marrin sinjalin nga studioja nëpërmjet linjave mikrovalore (radiorele). Kostoja e shpërndarjes së sinjalit vlerësohet 29% e buxhetit me një personel prej 250 punonjësish. Kostoja e shpërndarjes është shumë e lartë krahasuar me kompanitë transmetuese evropiane. Përgjithësisht kostoja e shpërndarjes së kompanive transmetuese evropiane nuk e kalon 10% të buxhetit total.

Sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, RTSH-së i takon të marrë frekuenca për ta mbuluar vendin me dy rrjete TV. Por, në perspektivën e pritshme të kalimit në transmetime numerike, ndërtimi i një rrjeti të dytë analog kombëtar konsiderohet si shpenzim i pajustificuar.

Në përgjithësi infrastruktura teknike e RTSH paraqitet e dobët. Furnizimi me energji elektrike në shkallë vendi nuk është i qëndrueshëm. Furnizimi i pandërprerë me energji nuk sigurohet plotësisht as në ndërtesën kryesore të RTSH-së. Kjo do të thotë se pajisjet janë vazhdimisht nën kërcënimin e ndërprerjes së energjisë.




Fig. 7 Mbulimi me sinjal analog tokësor ne bandën VHF i realizuar nga TVSH




Fig. 8 Mbulimi me sinjal analog tokësor ne bandën UHF i realizuar nga TVSH

4.6.1.3 Studiot

Në ndërtesën kryesore janë në përdorim tri studio të prodhimit televiziv. Pajisjet e prodhimit televiziv të RTSH-së sigurojnë vetëm “mbijetesën”. Mungesa e

ndjeshme e investimeve ka çuar në grumbullimin e vetëm pak pajisjeve relativisht bashkëkohore kundrejt një baze pajisjesh tejet të vjetruara.

Si pasojë ekziston një larmi pajisjesh nga shitës të ndryshëm me cilësi të ndryshme. Kalimi nga sinjalet analoge në numerike shkaktonte humbje të cilësisë. Me pajisjet ekzistuese (veçanërisht mungesa e monitorëve) kontrolli serioz i cilësisë bëhet shumë i vështirë ose në disa raste i pamundur.

4.6.1.4 Struktura e organizimit të RTSH-së

RTSH-ja duhet të rishqyrtojë dhe riorganizojë strukturën e saj organizative dhe personelin. Sfidat e reja që janë shfaqur në lidhje me teknologjinë numerike kërkojnë aftësi dhe personel të ri me formim bashkëkohor teknik dhe mediatik.

4.6.1.5 Financimi i RTSH-së

RTSH-ja ka katër burime bazë të ardhurash:

- Nga buxheti i shtetit - rreth 34 % nëpërmjet një granti vjetor shtetëror që miratohet çdo vit në Kuvend.
- Nga taksa e aparatit – rreth 8.5 %. Kjo taksë mblihet prej familjeve nëpërmjet faturave të energjisë elektrike.
- Nga shitja e reklamave dhe sponsorizimet – rreth 7%.
- Nga kontratat me të tretët – rreth 50 %.

Siç shihet, pjesa më e madhe e buxhetit, afërsisht 50% mbulohet prej kontratave me të tretët të cilët shfrytëzojnë kapacitetet teknike rezervë për transmetime të ndryshme dhe nga shitja e shërbimeve dhe programeve të tjera, etj. Kjo strukturë financimi jo e balancuar është indikator kryesor i nevojës urgjente për ristrukturimin e menaxhimit të këtij institucioni të rëndësishëm publik me një rëndësi të pazëvendësueshme në promovimin e vlerave të demokracisë. Ristrukturimi duhet të synojë drejt shndërrimit të RTSH-së në një operator publik, të pavarur nga strukturat shtetërore.

Pavarësia financiare përbën një nga kolonat ku mbështetet pavarësia në përgjithësi, prandaj RTSH duhet ndihmuar të sigurojë të ardhurat që do të garantojnë veprimtarinë normale të institucionit. Një ndihmë konkrete do të ishte mbështetja për përcaktimin e një niveli të përshtatshëm të taksës së aparatit dhe stabilizimin e një skeme efikase të grumbullimit të kësaj takse. Një ndërhyrje e tillë, duke balancuar skemën e financimit do të fokusonte përpjekjet e institucionit në detyrën kryesore që është edhe misioni i tij, në veprimtarinë mediatike, përmirësimi i së cilës do të sillte rritjen e të ardhurave nga reklamat, etj. Në këtë mënyrë do të zvogëlohej pesha e të ardhurave nga të tretët, që, sidoqoftë nuk mund të jetë veprimtaria kryesore e operatorit publik.

4.6.1.6 Numerizimi i RTSH-së

Për vetë misionin e tij, një numër dokumentesh të Këshillit të Evropës i ngarkojnë Televizionit Publik barrën kryesore në procesin e kalimit të plotë në transmetimet numerike të një vendi.

Sot, nëpërmjet programeve publike të transmetuara hapur dëgjuesit dhe shikuesit të shpërndarë në të gjithë territorin e vendit marrin programe informative, didaktike e argëtuese. Për këto programe, përdoruesit paguajnë vetëm një taksë vjetore të nivelit 4 euro.

Me qëllim që televizioni publik ta luajë këtë rol të pazëvendësueshëm edhe në epokën numerike, është e nevojshme të përcaktohet një program i detajuar që do të përmbajë të gjitha masat e nevojshme për ta realizuar këtë detyrë.

Paraprakisht është e nevojshme të përcaktohet profili mediatik i televizionit publik, që do të ndryshojë nga profili i televizioneve privatë komerciale. Në kuadrin e këtij profili duhet të përcaktohet numri i programeve publike kombëtare dhe rajonale duke u fokusuar në nevojat konkrete të audiencës dhe duke u shmangur nga joshjet e tendencat e komercializimit të skajshëm, karakteristike për televizionet privatë komerciale.

Një sfidë të vërtetë përbën financimi i ndërtimit të rrjetit numerik ku do të mbështeten programet e operatorit publik. Kombinimi i ndërtimit të rrjetit të operatorit publik me ndërtimin e rrjeteve të operatorëve vendorë do të shkurtojë kostot e përgjithshme të kalimit në numerik dhe ndoshta mund edhe të ulë kërkesat e vetë operatorit publik për kapacitete transmetues.

4.6.2 Operatorët kombëtarë privatë

Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2008 Këshilli Kombëtar, pasi shqyrtoi rezultatin e konkurrimit të kandidaturave, vendosi t'i akordojë subjektit "Top Channel" licencën si operator privat kombëtar. Ndërsa për operatorin e mësipërm viti 2008 ishte viti i parë i licencimit, për TV Arbëria dhe TV Klan ky vit është viti i fundit. Sipas ligjit në fuqi TV Arbëria dhe TV Klan këtë vit duhet t'u nënshtrohen procedurave të ri-licencimit.

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre. Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB ($\mu\text{V/m}$)

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

Vitet	Emërtimi	TVSH	R. Tirana	TVA	TV Klan	R.T. Alb	Radio +2	Top Channel
		Publik	Publik	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2002	Viti lic. 2008
2002	Viti i licencimit	----	----	2	2	2	----	----
	Kushtet e licencës	----	-----	7.33	7.33	28.85	----	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	27.39	40.91	87.22	-----	----
2003	Viti i licencimit	----	-----	3	3	3	1	----
	Kushtet e licencës	----	-----	26.4	26.4	55.76	10.11	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2004	Viti i licencimit	-----	-----	4	4	4	2	
	Kushtet e licencës	----	-----	46.97	46.97	72.69	28.87	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2005	Viti i licencimit	----	-----	5	5	5	3	
	Kushtet e licencës	----	-----	62.09	62.09	94.4	55.76	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2006	Viti i licencimit	----	-----	6	6	6	4	
	Kushtet e licencës	----	-----	75.71	75.71	90	72.68	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	----
2007	Viti i licencimit	----	-----	7	7	0	5	----
	Kushtet e licencës	----	-----	86.86	86.86	90	94.4	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	----
2008	Viti i licencimit	----	-----	8	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	90	50
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	40.8	69.8	87.22	72.64	62.1

4.6.2.1 Operatori kombëtar TVA

Në fund të vitit 2007 TVA ndërmori disa veprime për përmirësimin rrënjësor të mbulimit të gjithë territorit të Republikës për të plotësuar boshllëqet e viteve të kaluara.

Në mbështetje të përpjekjeve të TVA për të rritur prezencën në të gjithë territorin e vendit, gjatë vitit 2008 KKRT, ka bashkëpunuar ngushtë me personelin teknik të subjektit. Në këtë kuadër nga KKRT janë kryer disa herë llogaritjet e mbulimit dhe të interferencave, duke shfrytëzuar bazën e të dhënave dhe software-in e KKRT si dhe specialistët përkatës.

Rezultoi se me 13 stacionet transmetues të vendosur në pikat kryesore realizohej mbulimi i territorit të Shqipërisë vetëm në masën 45% (duke marrë pragun minimal të marrjes 60 dB μ) ose 51 % (me prag minimal 55 dB μ), shifra që ishin larg objektivit të mbulimit për vitin e fundit të licencimit (90%). Prandaj TVA-së i u rekomandua instalimi i stacioneve transmetues shtesë në 24 pika të tjera transmetuese në zona të largëta si Qafëprush, Mide, Kukës, Çervenakë, Sopot, Peqin, Çorovodë, Pepellash, Peshkopi, Ballsh, Gramsh, Pogradec Rrëshen, Bilisht, B. Curri, Tamara, Tyrbe Lezhë, Burrel, Klos, Homesh, Maqellarë, Bulqizë, Likovun, Macukull me qëllim që të arrihej mbulimi mbi 70% të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2008 Drejtoria Teknike ka ndjekur në vazhdimësi implementimin e stacioneve transmetuese në pikat e reja të akorduara.

Të dhënat e monitorimit kanë treguar paqëndrueshmëri në funksionimin e rrjetit të TVA. Janë evidentuar raste kur një stacion në një pikë të caktuar të rrjetit të TVA ka qenë në funksionim duke siguruar mbulim normal me sinjal, por janë regjistruar raste të tjera kur po ky stacion ka qenë jashtë pune për një kohë të gjatë.





Fig. 9 Pikat e transmetimit të planifikuara për TVA

MBULIMI I TERRITORIT NGA TV KOMBETAR ARBERIA ME FREKUENCAT E AKORDUARA NGA KKRT



Threshold 60 dBu

Perqindja e mbulimit te teritorit mbi 70 %

Fig. 10 Mbulimi me sinjal analog tokësor i llogaritur të përftohet nga vënia në punë e pikave të transmetimit të planifikuara për TVA

4.6.2.2 Operatori kombëtar TV Klan

Operatori Kombëtar TV KLAN ka treguar stabilitet në mbulimin e territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. Gjatë vitit 2008 TV KLAN ka bërë përpjekje për përmirësimin e mbulimit dhe ka bashkëpunuar me KKRT-në për identifikimin e zonave ku nevojitej ndërhyrje për përmirësim. Si rezultat, është instaluar një numër përsëritësish të rinj.

Figurat e mëposhtme paraqesin pikat ekzistuese të transmetimit të TV KLAN dhe mbulimin e territorit të realizuar nga këto pika. TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.





Fig. 11 Pikat e transmetimit të dhëna për TV Klan

**MBULIMI AKTUAL I TERRITORIT NGA
OPERATORI KOMBETAR TV KLAN**



Threshold 60

Perqindja e mbulimit te territorit 72.66 %

Fig. 12 Mbulimi me sinjal analog tokësor realizuar nga TV KLAN

4.6.2.3 Operatori kombëtar TOP Channel

Me shpalljen e televizionit Top Channel si Operator Televiziv Privat Kombëtar u akorduan nga KKRT frekuencat për 32 pika transmetuese. Deri më sot ky operator ka realizuar transmetimin në 18 pika transmetuese ekzistuese dhe të reja, duke arritur një mbulim të territorit të Republikës së Shqipërisë deri në 62 % ku objektivi për vitin e parë është 62 %. Nuk disponohen të dhëna për gjendjen e studiove të Top Channel-it nëpër rrethe.





Fig. 13 Pikat e transmetimit të Top Channel

**MBULIMI AKTUAL I TERRITORIT NGA
TV KOMBETAR TOP CHANNEL**



Threshold 60

Perqindja e mbulimit te territorit 62 %

Fig. 14 Mbulimi me sinjal analog tokësor i realizuar aktualisht nga Top Channel

4.6.3 Operatorët vendorë privatë

Gjatë vitit 2008 peizazhi audiovizual në Shqipëri u plotësua me operatorë të rinj radio (FM) dhe televizivë tokësorë të teknologjisë analoge, kryesisht në zona ku spektri i radio-frekuencave lejonte hapësira të lira, të cilat u krijuan edhe si rezultat i mbylljes së transmetimeve pa leje në vitin 2007¹⁴. Një proces i tillë gradual rregullimi ka përmirësuar zbatimin e ligjit dhe ka sjellë rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të frekuencave, duke rritur numrin e operatorëve, gjë që ka krijuar vlera të reja monetare dhe kulturore, sidomos në favor të komuniteteve lokale. Shtimi i operatorëve ka rritur konkurrencën në tregun mediatik, që përbën një faktor nxitës në rritjen e cilësisë.

Siç është theksuar edhe në raportimet paraardhëse, një numër operatorësh të licencuar, sidomos ata televizivë, nuk i mbulojnë plotësisht zonat e tyre të licencimit. Në kuadrin e diskutimeve për kalimin në transmetimet numerike,

Operatorët që rezultojnë me mbulim më të ulët vazhdojnë të jenë:

TV Gramshi	7.2 %
TV Berati	6.2 %

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

Tirana TV	42%,
Supersonic	61 %,

Televizione me mbulim të mirë

UFO (ish Teuta TV)	78.3 %
si dhe disa TV të vogla, (TV 4+, Klodiana, etj)	

Në transmetimet radiofonike, situata paraqitet e pandryshuar, me përjashtim të licencimit të disa operatorëve të rinj.

4.7 Transmetimet numerike ekzistues

Siç dihet, prej korrikut 2004, shoqëria DIGITALB i propozon shumicës së popullatës së territorit një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore (4 rrjete fikse dhe 1 mobil) dhe satelitore. Edhe pse kjo situatë është zhvilluar jashtë çdo kuadri ligjor, televizioni numerik tokësor përbën tashmë një realitet në Shqipëri.

Në sistemin numerik tokësor DIGITALB përdor 4 kanale frekuencash (për rrjetet fikse) dhe 1 kanal frekuencash (për rrjetin mobil) mbi pjesë të konsiderueshme të territorit (rrjet mono-frekuencë : SFN). Nëpërmjet rrjetit fiks DIGITALB transmeton

¹⁴ Shih Raporti vjetor KKRT për vitin 2007

38 programe (18 falas dhe 20 me pagesë) nga të cilët 15 prodhohen nga DIGITALB. Nga pikëpamja teknike, DIGITALB transmeton 9 deri 10 programe multipleks (norma DVB -T) për kanal ndërkohë që numri mesatar i programeve numerike është 6 deri 7 kanale (Në sistemin MPEG 2).

Këto 38 programe tregtohen nga DIGITALB në formën e 3 paketave që kërkojnë pagesën e një abonimi nga 7 në 20 € në muaj dhe pajisjen me një dekoder me akses të kushtëzuar (sistemi CONAX). Dekoderi për marrjen e sinjaleve numerike tokësore është projektuar të marrë vetëm kanalet në të cilat transmeton DIGITALB-i (Kanalet 62, 64, 67, 69). Numri i të abonuarve nuk bëhet i ditur, por ai është më i madh se 100 000 familje.

Në fakt, DIGITALB grumbullon të gjitha funksionet e kanalit numerik duke transmetuar 38 kanale (drejtimi i 4 multipleksëve) nga të cilët 15 prodhohen prej tij (operator programesh) dhe duke i tregtuar me abonim (distributor tregtar).

Në rrjetin Mobil, DIGITALB transmeton në një kanal tokësor, 16 kanale televizioni celular personal (norma DVB-H) që mund të kapen me një telefon celular (marka LG modeli KU 950) .

DIGITALB përbën kështu një aktor përcaktues për transmetimin numerik në Shqipëri dhe zotëron, për nga aktivitetet dhe njohuritë, një pozicion të pamohueshëm në procesin e kalimit në numerik në Shqipëri.

Aktualisht, në rajonin e Tiranës, ofrojnë transmetime numerike në mënyrë eksperimentale edhe Vizion+ dhe Shijak TV duke përdorur secili nga një kanal brenda planit të frekuencave numerike. Këto transmetime eksperimentale nuk do të thotë se subjektet e mësipërme do të gëzojnë ndonjë avantazh në garën për licencimin e rrjeteve numerike tokësore.




Fig. 15 Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik të Digitalb




Fig. 16 Skema e organizimit të sistemit DVB-T të Digitalb




Fig. 17 Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik DVB-H (mobil) të Digitalb




Fig. 18 Skema e organizimit të sistemit DVB-H të Digitalb

5 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN

5.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Forcimi i kapaciteteve administrative të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, ka qenë dhe mbetet një angazhim i përhershëm i institucionit, duke synuar zgjidhjen e të gjitha problematikave dhe shqetësimeve të identifikuara në vazhdimësi nga aktorët dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto përpjekje dhe angazhime janë vlerësuar edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, siç ishte rasti i Raportit të fundit të Komisionit Evropian (nëntor 2008), në të cilin, ndërmjet të tjerash, theksohej se:

“KKRT-ja ka zgjeruar kapacitetin administrativ dhe ka rritur stafin. Ajo ka transformuar Këshillin e Ankesave në një Këshill Etike. Këshilli i Etikës ka luajtur një rol pozitiv në vetë-rregullimin, inkurajimin dhe hartimin e një kodi etike nga çdo operator radiofonik dhe televiziv, me qëllimin e unifikimit të këtyre kodeve në një të vetëm.”

Mbështetur në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, nr. 184, datë 19.05.2008, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të KKRT-së”, gjatë muajit korrik – gusht 2008, në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil, KKRT-ja organizoi konkurset për dymbëdhjetë vendet e shpallura, me qëllim rekrutimin e punonjësve dhe emërimin e tyre në shërbimin civil, ndërkohë që ka nisur procedurat për rekrutimin edhe të pjesës së mbetur, duke plotësuar në këtë mënyrë të gjithë organikën e institucionit.

Ndryshimi i strukturës organizative, fuqizimi i kapaciteteve manaxhuese, përmirësimi i mjeteve e instrumenteve të domosdoshëm për mbështetjen e veprimtarisë së KKRT-së, ka përmirësuar ndjeshëm respektimin i konkurrencës së ndershme në tregun mediatik, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së autorit, monitorimin më të mirë dhe efikas të çështjeve që kanë të bëjnë me reklamat në media, problemet e etikës dhe moralit të programeve, luftën kundër piraterisë, respektimin e plotë të kriterëve të licencimit, monitorimin e transmetuesve, forcimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve me partneret ndërkombëtarë etj.

Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është përpjekur maksimalisht, brenda mundësive dhe kapaciteteve të kufizuara financiare që disponon, për ngritjen profesionale të punonjësve, nëpërmjet realizimit të trajnimeve të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit.

Siç është përmendur edhe më parë në këtë raport, në qershor të vitit 2008, u organizua për herë të parë nga shërbimet e Komisionit Evropian (në kuadër të programit "TAIEX") trajnimi i stafit të KKRT-së në lidhje me legjislacionin e BE-së dhe praktikën e vendeve anëtare në fushën e medias. Edhe për vitin 2009, për vetë rëndësinë që kanë këto trajnime, është kërkuar, pranë shërbimeve të Komisionit Evropian, organizmi i një tjetër seminary trajnues i fokusuar kryesisht në format dhe mënyrat e kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Nisur nga rëndësia që ka mbrojtja e të drejtave të autorit nga transmetimet pirate, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bashkëpunim me ambasadën amerikane në Tiranë, gjatë muajit mars 2008, organizoi një seminar trajnues me ekspertë amerikanë të kësaj fushe, për t'u njohur me format dhe instrumentet më efikase të mbrojtjes së këtyre të drejtave si dhe ofrimin e përvojës për luftën kundër piraterisë në median elektronikë dhe respektimin e të drejtave të autorit nga përdoruesit radiotelevizivë.

Gjithashtu, përfaqësues të KKRT-së, kanë qenë pjesëmarrës aktivë në shumë trajnime dhe seminare të tjera të organizuara për probleme të ndryshme që lidhen me fushën e medias, përfshirë aspektet ligjore, administrative ose teknike të saj, duke mundësuar marrjen dhe shkëmbimin e përvojave konkrete në këtë drejtim.

Në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, për vitin, 2009, është rënë dakord për pjesëmarrjen e punonjësve të KKRT-së në të gjitha trajnimet që ky Institut organizon për nëpunësit e administratës publike. Pavarësisht nga arritjet e deritanishme, gjojmë se kalimi në sistemin numerik do të përbëjë një nga sfidat madhore në fushën e medias, si një zhvillim shumë i rëndësishëm për operatorët dhe për publikun, suksesi i të cilit do të varet nga aftësia e institucioneve përgjegjëse për ta shoqëruar këtë lëvizje dhe për të bashkërenduar aktorët e ndryshëm të tij.

Në këtë kuptim, i takon instancës rregullatore, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, që ta shoqërojë këtë kalim. Megjithatë, burimet njerëzore dhe financiare mbeten të kufizuara për të përballuar këtë proces madhor, çka do ta vështirësonte dhe do të krijonte vonesa në respektimin e atyre afateve kohore të vendosura ndërkombëtarisht.

5.2 Struktura e Drejtorisë Teknike

Rregullimi i transmetimeve radio e televizive është një proces kompleks që përfshin inxhinierinë e rrjeteve, planifikimin e frekuencave, dhënie në përdorim dhe monitorimin e përdorimit.

Në varësi të KKRT, Drejtoria Teknike mbulon transmetimet radio dhe televizive në territorin e Shqipërisë nga pikëpamja e administrimit të frekuencave, cilësisë së mbulimit me sinjal, kompatibilitetit elektromagnetik dhe mbrojtjen nga

rrezatimet e dëmshme. Ajo siguron disponueshmërinë e frekuencave dhe funksionimin pa interferenca të transmetimeve radio e televizive. Drejtoria Teknike koordinon frekuencat për transmetime radio e televizive me vendet fqinjë dhe zbaton procedurat e modifikimit të planeve e notifikimit të frekuencave radiotevizive në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave, (ITU Gjenevë). Ajo monitoron cilësinë e mbulimit me sinjal të zonave të licencimit të operatorëve radio e televizivë.

Një nga drejtimet prioritare të punës së KKRT për vitin 2008 ka qenë ridimensionimi i Drejtorisë Teknike, në kuadrin e ristrukturimit të Autoritetit Rregullator, në përputhje me organikën e miratuar nga Kuvendi. Rritja e personelit të Drejtorisë Teknike nga 3 vetë në 7 i ka dhënë një impuls pozitiv punës për plotësimin e detyrave shumë të specializuara që u desh të kryheshin këtë vit për përfundimin e Planit të frekuencave numerike, projektimit të pikave të transmetimit numerike së bashku me llogaritjet teknike përkatëse, etj.

Por, duke patur parasysh specifikën e sektorit delikat të transmetimeve radio e televizive, sidomos zbatimi i standardeve të përparuara ndërkombëtare, koordinimin e tyre me vendet fqinjë, nxitjen e aplikimit të zhvillimeve më të fundit të teknologjisë si dhe rekomandimet e ekspertëve të huaj të fushës, ka vend për përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së Drejtorisë Teknike. KKRT gjykon se struktura do të rezultonte më funksionale e dinamike nëse në vend të dy sektorëve, kjo Drejtori të konceptohej me tre sektorë, duke shtuar sektorin e Inxhinierisë së rrjetit, që është i pranishëm në të gjitha strukturat e ngjajshme të rregullatorëve të Europës e më gjerë.

Bashkimi i sektorit të Inxhinierisë së rrjetit me sektorin e Monitorimit të Frekuencave krijon një disbalancim të punës së Drejtorisë, duke penguar lidhjen logjike midis sektorëve për të realizuar skemën "check - and - balance", që ndihmon në kontrollin dhe korregjimin reciprok të proceseve të ndryshme të rregullimit teknik të transmetimeve radio e televizive (Projektimin e rrjeteve të teknologjive të ndryshme, planifikimin e frekuencave për këto teknologji e përdorime, dhënia e frekuencave në përdorim të subjekteve të ndryshëm dhe kontrolli i vazhdueshëm i përdorimit).

Përveç kësaj të metë kryesore, Sektori i inxhinierisë së rrjeteve ishte projektuar për të mbuluar disa aktivitete specifike të një rëndësie të veçantë siç janë marrëdhëniet me Byronë e Radiokomunikacioneve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), lidhur me koordinimin e frekuencave me vendet fqinje, modifikimin e planeve të frekuencave për transmetime radiotevizive, evidentimi dhe informimi i materialeve të ITU të dërguara me qarkore të veçanta, ndjekja e grupeve të punës së ITU për përmirësimin e administrimit të frekuencave dhe futjen e teknologjive të reja, etj.

Gjithashtu, duke shtuar edhe personelin përkatës, ky sektor mund të mbulojë edhe problemet teknike të disa shërbimeve teknike të rrjeteve audiovizuale të

mbështetura në sisteme të ndryshme nga transmetimet radiotelevizive tokësore si transmetimet me kablo, satelit, MMDS si dhe shërbimet e reja që shoqërojnë transmetimet numerike tokësore. Për sa u trajtua më sipër, për vetë rëndësinë që paraqet sektori i mësipërm në veprimtarinë e krejt Drejtorisë teknike, është e nevojshme që Kuvendi të rishikojë mundësinë e miratimit të Sektorit në fjalë.

Duke iu referuar edhe raporteve e rekomandimeve të dhëna nga partnerët tanë ndërkombëtarë për nevojën e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare, me qëllim realizimin e plotë dhe në kohë të atyre hapave që do të kërkonte kalimi në sistemin numerik, do të vlerësohej i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i rolit rregullator të KKRT-së, duke rritur dhe forcuar më tej, përmes ndërhyrjeve ligjore, pavarësinë e autoritetit, fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative, financiare dhe teknike të tij, si instrumente të nevojshme që do t'i shërbenin realizimit me sukses të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Një problem shqetësues i ngritur edhe në Raportin e fundit të Komisionit Evropian janë edhe *"kapacitetet e pamjaftueshme monitoruese të KKRT-së"*. Duhet të theksohet se ky element ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm i shprehur nga KKRT-ja edhe në takimet e zhvilluara me Komisionin Evropian, duke synuar sensibilizimin e palës komunitare për nevojën që ka KKRT-ja për mbështetje këtë drejtim.

Kjo ka qenë edhe arsyeja që, në kuadër të asistencës komunitare, programi "IPA", në mënyrë të përsëritur, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka kërkuar financimin e një projekti me vlerë mbi një milionë euro, që përqendrohet në katër shtylla themelore, ku më kryesorja vlerësohet krijimi i një studioje monitorimi "online". Realizimi i këtij projekti do të mundësonte fuqizimin e kapaciteteve teknike në funksion të monitorimit të plotë të programeve televizive në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Realizimi me sukses i tij është i lidhur ngushtësisht edhe me një shqetësim të vazhdueshëm që ekziston në lidhje me pajisjen me mjedise të reja pune të KKRT-së, të cilat mund t'i garantojnë institucionit një funksionim normal.

Kjo problematikë u është bërë e njohur niveleve më të larta, por nuk ka gjetur akoma rrugën e duhur të zgjidhjes, gjë që mund të krijojë vështirësi serioze në realizimin e angazhimeve ose rekomandimeve të vazhdueshme që vijnë edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Me këtë rast, në emër të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, do të kërkoja nga institucionet përkatëse ofrimin e një zgjidhjeje të shpejtë dhe përfundimtare në lidhje me akomodimin në mjedise të përshtatshme pune për KKRT-në.

5.3 Marrëdhëniet me jashtë

Si një institucion, i cili ka punuar në vijimësi për të forcuar marrëdhëniet me partnerët dhe organizmat ndërkombëtarë, në kuadër edhe të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, për t'u përqasur me standardet dhe praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, këtë fushë, edhe për vitin raportues, e ka trajtuar dhe e trajton me rëndësi të veçantë.

Me formalizimin dhe ngritjen e një strukture të veçantë përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e këtyre marrëdhënieve, është intensifikuar në vazhdimësi puna për forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e medias, shkëmbimin e përvojave me vendet partnere nëpërmjet njohjes së praktikave më të mira, si dhe përfitimit nga organizmat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Ky bashkëpunim është formalizuar përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të KKRT-së në shumë takime dhe veprimtari të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, me rëndësi të veçantë për fushën e medias, siç është p.sh. kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike.

Në këtë aspekt, në kuadër të politikave trajnuese të ndjekura nga KKRT-ja, vlen të përmendet organizimi për herë të parë në Shqipëri, i një seminari trajnues për stafin e KKRT-së në lidhje me politikave të reja audio-vizuale evropiane. Ky trajnim, i cili u zhvillua në Tiranë, në qershor 2008, u organizua me mbështetjen e Komisionit Evropian në kuadër të programit "TAIEX". Në të morën pjesë dhe shkëmbyen përvojat e vendeve përkatëse përfaqësues të fushës së medias nga disa vende anëtare të Bashkimit Evropian. Ky trajnim u kërkua nga KKRT-ja, duke pasur parasysh nevojat që ka institucioni për t'u njohur me standardet dhe praktikave evropiane si dhe për qasjen e legjislacionit shqiptar me këto standarde.

Edhe për vitin raportues, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët dhe organizmat ndërkombëtare, bashkëpunimi me OSBE-në, mbetet i një rëndësie të veçantë për vetë rolin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kjo organizatë ka dhënë për fushën e medias në Shqipëri.

Në bashkëpunim me këtë organizatë ndërkombëtare, gjatë periudhës prill-qershor 2008, u mundësua realizimi i një procesi të gjerë këshillimi publik për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjithë operatorët radio-televizivë, me qëllim hartimin e strategjisë kombëtare të kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Në vijim të bashkëpunimit në këtë fushë, si dhe duke pasur parasysh kërkesën e KKRT-së për institucionalizimin e bashkëpunimit për procesin e dixhitalizimit të medias elektronike në Shqipëri, në datën 27 nëntor 2008, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit për zbatimin e projektit "Mbështetje për dixhitalizimin e televizionit shqiptar".

Marrëveshja e nënshkruar, ka si qëllim kryesor të mbështesë KKRT-në në hartimin e një strategjie kombëtare rregulluese për sektorin e radio-televizionit si pjesë e zhvillimeve audiovizuale në Shqipëri. Ky projekt do të sigurojë pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha palët e interesuara duke kërkuar ndihmesën e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e kalimit në transmetimet numerike në Shqipëri.

Gjithashtu, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, OSBE-ja do të mbështesë KKRT-në në ngritjen e një strukture të fortë institucionale për bashkërendimin dhe zbatimin e procesit kompleks të kalimit në transmetime numerike si dhe në zhvillimin e konferencave, seminareve dhe diskutimeve të nevojshme gjatë procesit të këshillimit.

Nisur nga nevoja dhe kërkesa për forcimin e bashkëpunimit edhe me vende të tjera, janë vendosur tashmë urat e bashkëpunimit edhe me Autoritetin Audiovizual Francez (CSA – Conseil Supérieur de l'Audiovisuel). Një delegacion nga KKRT-ja, në muajin prill 2008, bëri një vizitë pranë Autoritetit Audiovizual Francez, ku u njoh me praktikën dhe përvojën e këtij vendi, çka do të shërbejë si shembull pozitiv edhe për hapat që duhet të ndërmerret Shqipëria në kuadër të kalimit në transmetimet numerike.

Parë në këtë aspekt, palët janë duke përgatitur një Memorandum Bashkëpunimi, në të cilën do të përfshihen fushat e bashkëpunimit si dhe ndihma konkrete që mund të ofrojë organizmi audio-vizual francez për zhvillimin e mëtejshëm të fushës së medias në Shqipëri.

Memorandumi i Bashkëpunimit do të firmoset në muajin mars 2009, gjatë vizitës zyrtare që Presidenti i CSA-së pritët të zhvillojë në Shqipëri.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, si anëtar me të drejta të plota në disa prej organizmave ndërkombëtare në fushën e politikave audiovizuale, ka vlerësuar gjithmonë nevojën e pjesëmarrjes aktive në të gjitha veprimtaritë e organizuara prej tyre, me qëllim shkëmbimin e përvojës me vendet e tjera anëtare si dhe përfitimin nga mundësitë që rrjedhin nga anëtarësimi në këto organizata.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, gjatë këtij viti raportues, ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare në këtë fushë, të tilla si EPRA, ITU, Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare (RIRM), në konferenca dhe seminare trajnuese të ndryshme ndërkombëtare etj., duke qenë aktiv për shfrytëzimin e këtyre takimeve ndërkombëtare ose seminareve të ndryshme në funksion të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe si dhe njohjes së përvojave më të mira në këtë fushë.

5.4 Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit

Në thelb të këtyre marrëdhënieve qëndron pjesëmarrja e publikut dhe bashkëpunimi i ndërsjellë. Përvoja tregon se një demokraci mund të jetë e suksesshme vetëm me pjesëmarrje aktive të shtetasve. Dhe kjo pjesëmarrje lidhet plotësisht me transparencën e çdo institucioni shtetëror që e lejon publikun të shohë se çfarë ndodh në këtë institucion, çfarë qëndron pas çdo vendimi të tij dhe përse e në ç'mënyrë këto vendime ndikojnë në jetën publike.

Qasja e lirë në dhënien e informacionit zgjeron lirinë e informimit publik dhe plotëson korpusin e të drejtave të garantuara të njeriut. Qytetarët e kanë një mundësi të qartë që të qasen në informacione nga të cilat do të varet krijimi dhe shprehja e politikave të tyre sovraane, por gjithashtu do ta kenë më lehtë të kontrollojnë institucionet e administratës shtetërore.

Duke u mbështetur në parimin "*Opinionit publik ka të drejtë të dijë*", transparencja e vazhdueshme e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit si dhe zhvillimi i një komunikimi të pandërprerë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, ka qenë dhe mbetet një objektiv parësor i këtij institucioni.

Kjo është vënë re në të gjitha hapat e ndërmarrë në veprimtarinë e KKRT-së, që ka synuar dhe synon informimin dhe transparencën me publikun, transparencën e vendimeve të marra ndaj çdo subjekti mediatik, duke respektuar, në çdo moment të punës së saj, kriteret dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Të gjitha vendimet e marra nga KKRT-ja, i janë nënshtruar të gjitha fazave dhe proceduarave transparente, të parashikuara nga kuadri ligjor ekzistues, duke nisur që nga shpallja publike e garës për çdo frekuencë të dhënë dhe deri në publikimin, në fletoren zyrtare, të vendimeve të marra.

Një nga instrumentet e komunikimit të vazhdueshëm me operatorët por edhe me publikun ka qenë dhe mbetet faqja elektronike e KKRT-së, e cila i është nënshtruar përmirësimeve të vazhdueshme, duke synuar dhënien e një informacioni sa më të plotë dhe të detajuar për të gjithë veprimtarinë e kryer nga KKRT-ja si dhe marrjen e çdo informacioni, rekomandimi ose sugjerimi të dobishëm nga publiku i gjerë si dhe nga operatorët radiotelevizivë për përmirësimin e mëtejshëm të kësaj faqeje.

Një tjetër projekt, i cili ka filluar të zbatohet që në vitin 2008, është ngritja e një minibiblioteke profesionale brenda hapësirave të Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit, e konceptuar sipas modelit të qendrave të dokumentacionit evropian. Një pjesë të rëndësishme të kësaj mini-biblioteke do ta zënë aktet e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, duke synuar ofrimin e një informacioni të bollshëm në lidhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në kuadër të përmirësimit të komunikimit dhe transparencës me operatorët dhe publikun, është duke punuar për vendosjen e kontakteve të përhershme me kategori të ndryshme shoqërore, përfshirë drejtuesit e mediave audiovizuale, analistët dhe gazetarët e shtypit elektronik dhe të shkruar, studentët etj., duke e bërë me efikas dhe transparent rolin që duhet të luajë ky institucion në raport me shtresa të ndryshme shoqërore dhe aktorët mediatikë.

Forcimi i rolit të Këshillit të Etikës dhe marrëdhënieve të tij me qytetarët, në funksion të ruajtjes së etikës në transmetimet audiovizuale dhe respektimit të normave etike dhe ligjore, ka qenë një tjetër përparësi e Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Kësaj i kanë shërbyer edhe një sërë takimesh dhe seminaresh të zhvilluara në këtë drejtim, në lidhje me etikën në programet televizive, respektimin e kodit etik, zbatimin e normës së gjuhës shqipe, të ruajtjes së dinjitetit dhe privatësisë së njeriut, të mbrojtjes së të miturve nga dhuna ose nga abuzimi etj.

Kalimi në sistemin numerik përbën një zhvillim shumë të rëndësishëm për vetë operatorët dhe për publikun, suksesi i të cilit varet nga aftësia e institucioneve për ta shoqëruar këtë lëvizje dhe për të bashkërenduar aktorët e ndryshëm të tij. Realizimi me sukses dhe kalimi drejt sistemit të plotë numerik kërkon, mbi të gjitha, bashkëpunim. I gjithë ky proces i rëndësishëm, nuk mund të realizohet dot nga një institucion i vetëm, por ai përfshin një mjedis të gjerë partnerësh ku përfshihen strukturat shtetërore, legjislative dhe ekzekutive, organizatat jo-qeveritare në fushën e medias, operatorët si dhe vetë qytetarët dhe konsumatorët.

Për këtë arsye, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ndërmori realizimin e një këshillimi të gjerë publik dhe bashkëpunimi me një numër sa më të gjerë të mundshëm të aktorëve të interesuar. Ky këshillim publik është në linjë me praktikën dhe dokumentet përkatëse të politikave të Bashkimit Evropian. Përvoja evropiane tregon që një tranzicion i harmonizuar drejt transmetimeve numerike kërkon një konsensus të gjerë ndërmjet aktorëve të interesuar, në mënyrë të veçantë në procesin e miratimit të një strategjie me interes të përgjithshëm.

Në kuadër të zhvillimit të një këshillimi të gjerë publik, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në bashkëpunim edhe me partnerë ndërkombëtarë si OSBE-ja, ndërmori një tërësi hapash dhe masash ku përfshihen: këshillimi "online", organizimi i takimeve dhe konferencave të ndryshme, kombëtare dhe rajonale, të cilat u zhvilluan në qytetet kryesore të vendit, e ndarë në dy faza:

Faza e parë në periudhën prill – qershor 2008, katër konferencat, kombëtare dhe lokale "Shqipëria dixhitale – sfida e së ardhmes", dhe

Faza e dytë në periudhën nëntor - dhjetor 2008, tri Forumet e Diskutimit dhe Informimit për njohjen më konkrete të operatorëve me sfidat e këtij procesi si dhe për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre;

Këto konferenca dhe takime shërbyen për qartësimin e ideve dhe kristalizimin e objektivave që duhet të realizohen për zbatimin me sukses të shndërrimit rrënjësor të peizazhit të mediave elektronike në Shqipëri.

Dhënia e ideve dhe rekomandimeve të ndryshme nga aktorët e interesuar, kryesisht nga operatorët radiotelevizivë, ka qenë një ndihmesë reale në përcaktimin e hapave që duhet të ndiqte procesi. Nëpërmjet këtij procesi këshillimi janë identifikuar dhe përcaktuar format më optimale të bashkëpunimit me operatorët, si aktorë themelorë në këtë proces, për ndërtimin e platformave vendore, rajonale e kombëtare, ku do të mbështeten me përparësi programet ekzistuese, dhe pas tyre, programet e reja të përgjithshme ose tematike, sipas kërkesave të tregut dhe parapëlqimeve të publikut.

Ndihmesat e ofruara nga të gjithë aktorët e interesuar janë tashmë pjesë e rëndësishme e këtij dokumenti strategjik për kalimin në sistemin numerik. Duhet të theksohet se, këshillimi publik është një proces që nuk përfundon me miratimin e këtij dokumenti, por që do të nevojitet të vazhdojë gjatë gjithë fazës së kalimit në sistemin numerik, si një instrument efikas në funksion të marrjes në konsideratë të të gjithë aktorëve dhe faktorëve që janë pjesë e këtij procesi.

6 BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË

Gjatë vitit 2008, në drejtim të funksionimit racional të administratës së KKRT si dhe njohjes së situatës ekonomike e financiare të aktivitetit radioteleviziv të operatorëve, janë respektuar dhe zbatuar ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ligji 9742, datë 28.05.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme në fushën e ekonomisë dhe të financave.

Në përputhje dhe në zbatim të ligjit 9742, datë 28.05.2007 “ Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, KKRT ka punuar për llogaritjen e pagesave vjetore për licencë të operatorëve numerikë dhe përfshirjen e tyre në rregulloret, pjesë e ligjit.

Llogaritja e pagesave vjetore për licencë është realizuar nisur nga tarifat aktuale të operatorëve analogë, nga tendenca e tregut si dhe nga nevoja e mbulimit të shpenzimeve aktuale vjetore të KKRT-së. Në llogaritje janë marrë parasysh kalimi i shkallëzuar i operatorëve nga analogë në numerikë për një periudhë kohore pesëvjeçare – deri në fund të vitit 2012, përballimi i shpenzimeve të KKRT, në mënyrë të kombinuar, nga dy burime të ardhurash – të ardhura nga operatorët analogë dhe të ardhurat nga operatorët numerikë, kohëzgjatja e aplikimit të tarifave, e barabartë me kohëzgjatjen e licencave të operatorëve numerike prej tetë deri në dhjetë vjet si dhe diferenca në kohë e shlyerjes së detyrimeve të pagesave.

Me shpalljen e garës për operatorët numerikë televizivë kombëtarë, është punuar për hartimin dhe përgatitjen e dokumentacionit ekonomik e financiar, pjesë e dokumentacionit të konkurimit.

6.1 Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Treguesit financiarë për vitin 2008, janë miratuar sipas strukturës si më poshtë:

	Në milion lekë
Të ardhura të krijuara në vitin 2008	49.1
Përdorim të ardhura nga gjendja	50.6
Shpenzime korrente	74.4
Shpenzime për investime	25.3


Burimi i financimit të aktivitetit të KKRT i parashikuar për vitin 2008, në zërin Të Ardhura:

Nr.	Të ardhurat për vitin 2008	Shuma (milion lekë)
1.	Pagesa vjetore për licencë për vitin 2008	46
2.	Pagesa për përpunim dokumentacioni	0.9
3.	Të ardhurat nga Agjenti tatimor	0.9
4.	Të ardhurat nga interesa bankare	1.2
5.	Të ardhura të tjera	0.1
	Gjithsej	49.1

Burimet e financimit të shpenzimeve për vitin 2008 janë të ardhurat të cilat do të realizoheshin në vitin 2008 sipas planit të miratuar si dhe të ardhurat e realizuara dhe të trashëguara nga vitet e mëparshme.

Realizimi i treguesve financiarë - TË ARDHURAT

Në planin financiar të miratuar për vitin 2008, ishte parashikuar të siguroheshin të ardhura vjetore në shumën prej 49.1 milion lekë. Realizimi i këtij treguesi, në vlerën prej 41.2 milion lekë ose rreth 84%, pasqyrohet si më poshtë:



Gjithashtu, në vitin 2008 janë realizuar edhe 13.5 milion lekë të ardhura, të parashikuara dhe të parealizuarra për vitin 2007.

Si rrjedhojë, Të ardhura të arkëtuara në vitin 2008 janë 54.7 milion lekë.


Pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen e licencës.

Burimi kryesor i të ardhurave të institucionit, ose rreth 94 % e tyre, janë pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen dhe rinovimin e licencës. Këto pagesa shlyhen nga operatorët radiotelevizivë të cilët operojnë në fushën e mediave elektronike.

Për vitin 2008 pjesëmarrja në aktivitetin radioteleviziv pasqyrohet:



Në vitin 2008, janë realizuar 39.4 milion lekë të ardhura nga pagesat për licencë të vitit 2008 ose rreth 80.22 % e parashikimit.



84 % e numrit të operatorëve radio FM kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licencë në shumën prej rreth 4.7 milion lekë ose rreth 73%, rreth 77 % e numrit të operatorëve TV kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licencë në shumën prej rreth 28.2 milion lekë ose rreth 91 %, Nga TV me kabëll 76 % e operatorëve, kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licencë në shumën prej rreth 6.6 milion lekë ose rreth 55 %.

Pagesa vjetore e licencës, diferenca nga viti 2007

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

Pagesat e mbartura nga viti paraardhës krijohen pasi pagesat vjetore faturohen në vitin paraardhës por paguhen në vitin pasardhës, nisur nga fakti që pagesa vjetore për licencë llogaritet për vit licencimi ose nuk janë shlyer nga operatorët. Në rastin kur ato nuk janë shlyer, KKRT merr masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës.

Shuma e pagesave të mbartura nga viti 2007 dhe të arkëtuara në vitin 2008 është 13.5 milion lekë.

Të ardhurat nga agjenti tatimor – Taksat për shërbimet RTV

Në mbështetje të dispozitave ligjore për sistemin e taksave, KKRT në rolin e agjentit tatimor derdh në buxhetin e shtetit taksën vjetore të subjekteve RTV, e cila arkëtohet për llogari të Tatim Taksave. Për këtë KKRT përfiton 5% të vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit.

82% e numrit të operatorëve radio FM kanë shlyer detyrimet e taksave për frekuencë në shumën prej rreth 1.69 milion lekë ose rreth 93%. Rreth 72% e numrit të operatorëve TV (jo kabllorë) kanë shlyer detyrimet e taksave për frekuencë në shumën prej rreth 11 milion lekë ose rreth 82%. Për vitin 2008 janë derdhur në buxhetin e shtetit rreth 13.3 milion lekë, ndërsa janë përfituar rreth 0.63 milion lekë nga KKRT, si agjent tatimor.

Të ardhura nga interesa bankare

Janë përfituar rreth 1.09 milion lekë interesa bankare për fondet e depozituara në bankë për periudhën Janar – Dhjetor 2008.

Realizimi i treguesve financiarë - SHPENZIMET

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 155, datë 13.02.2008 "Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2008", përcakton Shpenzimet sipas strukturës së mëposhtme:

	Në milionë lekë
Shpenzime korrente	74.4
Shpenzime për Investime	25.3

Për periudhën Janar – Dhjetor 2008 realizimi i shpenzimeve sipas strukturës paraqitet:


Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime korrente	74.4	63.9	85.8

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

	a) Paga e kontribute	50.4	45.6	90.4
	b) Shpenzime materiale e të tjera	24	18.3	76.2
2.	Shpenzime për investime	25.3	2.4	9.4
	a) Blerje pajisje zyre e softë informatike	5.3	0.8	15
	b) Rikonstruksion i ambient. hidrosanitare	1.92	1.56	81
	c) Qendra e monitorimit në distancë	18	0	

Shpenzime korrente

Shpenzimet operative për vitin 2008, janë realizuar në masën prej 63.87 milion lekë ose 85.8%. Në përqindjen e mësipërme ka ndikuar plotësimi i organikës së miratuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 duke sjellë mosrealizim të fondit të pagave dhe të fondit të sigurimeve shoqërore në masën e parashikuar.



Shpenzimet për investime

Treguesi i investimeve për vitin 2008 është realizuar në masën 2.4 milionë lekë ose rreth 10% e parashikimit. Arsyeja e përqindjes së ulët të realizimit të treguesit të investimeve ka qenë shtyrja e projektit për monitorimin në distancë, fondet për realizimin e të cilit janë parashikuar në masën prej 18 milion lekë.

Si rezultat i veprimtarisë ekonomike për vitin 2008, në llogarinë bankare të institucionit në datën 23.01.2009 rezultojnë gjendja 65 milion lekë.


6.2 Bilancet kontabël të operatorëve RTV

Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" detyron operatorët radiotelevizivë të depozitojnë pranë KKRT-së bilancet vjetore të hartuar në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin, të vulosur e signuar nga drejtoritë e tatimeve në rrethe.


Nga analiza e treguesve financiarë të pasqyruar në bilancet kontabël të operatorëve RTV rezultojnë se në vitin 2008 është rritur numri i operatorëve të cilët

kanë depozituar bilancet kontabël pranë Drejtorisë Ekonomike në krahasim me vitet e mëparshme.

Operatorët të klasifikuar në biznesin e vogël, që mbulojnë një ose dy rrethe, kanë një aktivitet të qëndrueshëm, me rezultat financiar pozitiv – fitim, megjithëse në shifra të ulëta. Është rritur numri i operatorëve të deklaruar me fitim. Për vitin 2008, 80% e operatorëve të cilët kanë dorëzuar bilanc janë rentabël, ndërsa vetëm 20% e operatorëve që kanë dorëzuar bilancin kontabël janë me rezultat negativ. Operatorët të deklaruar me rezultat financiar negativ – humbje janë kryesisht operatorët me shtrirje deri në katër prefektura.



Asetet e trupëzuara të deklaruar nga operatorët RTV në bilancet e tyre, janë më të mëdha ose të barabarta me kriterin e kapitalit të kërkuar në momentin e marrjes së licencës. Treguesi “Të ardhurat nga reklamat”, në vitin 2008 në krahasim me vitet e mëparshme ka një rënie të pandjeshme, prej rreth 1%.



Neni 13 i ligjit nr. 8410, përcakton se KKRT-ja mund të përfitojë edhe nga dhurimet financiare ose materiale. Gjatë vitit 2008, në vazhdim të aktiviteteve të këshillimit publik për hartimin e strategjisë së transmetimeve numerike, janë organizuar konferenca “Shqipëria dixhitale – sfidë e së ardhmes” si dhe “Strategjia e këshillimit publik” me financimin pjesor ose tërësor nga OSBE, në shumën prej rreth 1.29 milion lekë. Gjithashtu, përsëri nga OSBE, janë bërë

Raporti i KKRT-së për vitin 2008

donacione në bazë materiale të vlerësuara në shumën prej rreth 0.09 milion lekë. Pra, shuma e donacioneve për vitin 2008 është rreth 1.37 milion lekë.

Nga kontrolli i ushtruar nga Grupi i Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit" për periudhën 1.08.2006 deri 31.10.2008, rezultoi se KKRT e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare, duke zbatuar Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave krahas legjislacionit specifik në fushën e mediave elektronike. Rezultatet e Kontrollit janë në fazën e Projekt-Raportit, në pritje të Raportit Përfundimtar.

8 ANEKS (Tabela Financiare)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT
DREJTORIA EKONOMIKE

000/lekë

Nr.	Emërtimi i subjektit	Rrethi	Pagesat për licensë	Pagesat marrje e rinovim	Paguar	Detyrimi
1	TV Me kabëll Eri A&A	Ballsh	100		100	
2	TV Me kabëll Irla	Berat	200		200	
3	TV Me kabëll Iliria	Berat	200		200	
4	TV Me kabëll Bilisht	Bilisht	100	50	150	
5	TV Me kabëll Bulqiza	Bulqizë	100		100	
6	TV Me kabëll Delvina	Delvinë	100		100	
7	TV Me kabëll Ai - Te	Durrës	550			550
8	TV Me kabëll KL-ED	Durrës	350		100	250
9	TV Me kabëll Elbasat	Elbasan	350		350	
10	TV Me kabëll Egnatia	Elbasan	650		650	
11	Tv Me kabëll Kombi	Fier	200		200	
12	TV Me kabëll AVN	Fier				
13	TV Me kabëll Ir-Gen	Gjrokastër	100		100	
14	TV Me kabëll Devi	Gramsh	100		100	
15	TV Me kabëll Multivizion	Kavajë	100		100	
16	TV Me kabëll Blu	Kavajë	100			100
17	TV Me kabëll Korca	Korçë	300		300	
18	TV Me kabëll Ju - Ai	Krujë	100			100
19	TV Me kabëll Kucove	Kucovë	100		100	
20	TV Me kabëll Kukesi	Kukës	100		100	
21	Tv Me kabëll Lissus	Lezhë	100		100	
22	TV Me kabëll Lezha	Lezhë	200	50	150	100
23	TV Me kabëll Lushnja	Lushnje	200		200	
24	TV Me kabëll Divjake	Lushnje	100	50	150	
25	TV Me kabëll Fokus	Maliq	100		100	
26	TV Me kabëll Mati	Mat	100		100	
27	TV Me kabëll APT	Memaliaj	300		300	
28	TV Me kabëll Memaliaj	Memaliaj	100		75	25
29	TV Me kabëll Mirdita	Mirditë	100		100	
30	TV Me kabëll KAM	Peqin	100		100	
31	TV Me kabëll Permet	Përmet	100		100	
32	TV me kabëll HB - CA	Peshkopi	100		100	
33	TV Me kabëll INKUSAT	Pogradec	100		100	
34	TV Me kabëll Delta	Pogradec	100	50		150
35	TV Me kabëll Prenjas	Prrenjas	100	50	150	
36	TV Me kabëll Asparag	Rrogozhinë	100		100	
37	TV Me kabëll Butrinti	Sarandë				
38	TV Me kabëll Erzeni	Shijak	100		100	
39	TV Me kabëll Synej	Shijak	100			100
40	TV Me kabëll Danja	Shkoder	100	50	150	
41	TV Me kabëll Ani	Skrapar	100		100	
42	TV Me kabëll Polican	Skrapar	100		100	
43	TV Me kabëll Tepelena Sat	Tepelenë	100		100	
44	TV Me kabëll DCN	Tiranë	1000			1000
45	TV Me kabëll Star	Tiranë	1000		500	500
46	TV Me kabëll Alfa Tirane	Tiranë	1350			1350
47	TV Me kabëll Di - TV	Tiranë	1000			1000
48	TV Me kabëll Kamez	Tiranë	200	50		250
49	TV Me kabëll Ura Vajgurore	Ura Vajgurore	100		100	
50	TV Me kabëll Trio	Vlorë	350		350	
51	TV Me kabëll Orikum	Vlorë	100	50	150	
52	TV Me kabëll S3	Vore	100	50	150	
Shuma			11700	450	6675	5475
Realizimi në përqindje					54.94	

Informacion i datës 26.1.2009

Raporti i KKRT-së për vitin 2008



KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT
DREJTORIA EKONOMIKE

000/lekë

Nr.	Emërtimi i subjektit	Rrethi	Pagesat për licensë	Pagesat marrje e rinovim	Paguar	Detyrimi
1	TV Me kabëll Eri A&A	Ballsh	100		100	
2	TV Me kabëll Irla	Berat	200		200	
3	TV Me kabëll Iliria	Berat	200		200	
4	TV Me kabëll Bilisht	Bilisht	100	50	150	
5	TV Me kabëll Bulqiza	Bulqizë	100		100	
6	TV Me kabëll Delvina	Delvinë	100		100	
7	TV Me kabëll AI - Te	Durrës	550			550
8	TV Me kabëll KL-ED	Durrës	350		100	250
9	TV Me kabëll Elbasat	Elbasan	350		350	
10	TV Me kabëll Egnatia	Elbasan	650		650	
11	Tv Me kabëll Kombi	Fier	200		200	
12	TV Me kabëll AVN	Fier				
13	TV Me kabëll Ir-Gen	Gjirokastrë	100		100	
14	TV Me kabëll Devi	Gramsh	100		100	
15	TV Me kabëll Multivizion	Kavajë	100		100	
16	TV Me kabëll Blu	Kavajë	100			100
17	TV Me kabëll Korca	Korçë	300		300	
18	TV Me kabëll Ju - AI	Krujë	100			100
19	TV Me kabëll Kucove	Kucovë	100		100	
20	TV Me kabëll Kukesi	Kukës	100		100	
21	Tv Me kabëll Lissus	Lezhë	100		100	
22	TV Me kabëll Lezha	Lezhë	200	50	150	100
23	TV Me kabëll Lushnja	Lushnje	200		200	
24	TV Me kabëll Divjake	Lushnje	100	50	150	
25	TV Me kabëll Fokus	Maliq	100		100	
26	TV Me kabëll Mati	Mat	100		100	
27	TV Me kabëll APT	Memaliaj	300		300	
28	TV Me kabëll Memaliaj	Memaliaj	100		75	25
29	TV Me kabëll Mirdita	Mirditë	100		100	
30	TV Me kabëll KAM	Peqin	100		100	
31	TV Me kabëll Permet	Përmet	100		100	
32	TV me kabëll HB - CA	Peshkopi	100		100	
33	TV Me kabëll INKUSAT	Pogradec	100		100	
34	TV Me kabëll Delta	Pogradec	100	50		150
35	TV Me kabëll Prrenjas	Prrenjas	100	50	150	
36	TV Me kabëll Asparag	Rrogozhinë	100		100	
37	TV Me kabëll Butrinti	Sarandë				
38	TV Me kabëll Erzeni	Shijak	100		100	
39	TV Me kabëll Synej	Shijak	100			100
40	TV Me kabëll Danja	Shkoder	100	50	150	
41	TV Me kabëll Ani	Skrapar	100		100	
42	TV Me kabëll Polican	Skrapar	100		100	
43	TV Me kabëll Tepelena Sat	Tepelenë	100		100	
44	TV Me kabëll DCN	Tiranë	1000			1000
45	TV Me kabëll Star	Tiranë	1000		500	500
46	TV Me kabëll Alfa Tirane	Tiranë	1350			1350
47	TV Me kabëll Di - TV	Tiranë	1000			1000
48	TV Me kabëll Kamez	Tiranë	200	50		250
49	TV Me kabëll Ura Vajgurore	Ura Vajgurore	100		100	
50	TV Me kabëll Trio	Vlorë	350		350	
51	TV Me kabëll Orikum	Vlorë	100	50	150	
52	TV Me kabëll S3	Vore	100	50	150	
Shuma			11700	450	6675	5475
Realizimi në përqindje					54.94	

Informacion i datës 26.1.2009

Raporti i KKRT-së për vitin 2008



KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT
DREJTORIA EKONOMIKE

000/lekë

Nr.	Emërtimi i subjektit	Rrethi	Pagesat për licensë	Pagesat marrje e rinovim	Paguar	Detyrimi
1	TV Me kabëll Eri A&A	Ballsh	100		100	
2	TV Me kabëll Irla	Berat	200		200	
3	TV Me kabëll Iliria	Berat	200		200	
4	TV Me kabëll Bilisht	Bilisht	100	50	150	
5	TV Me kabëll Bulqiza	Bulqizë	100		100	
6	TV Me kabëll Delvina	Delvinë	100		100	
7	TV Me kabëll AI - Te	Durrës	550			550
8	TV Me kabëll KL-ED	Durrës	350		100	250
9	TV Me kabëll Elbasat	Elbasan	350		350	
10	TV Me kabëll Egnatia	Elbasan	650		650	
11	Tv Me kabëll Kombi	Fier	200		200	
12	TV Me kabëll AVN	Fier				
13	TV Me kabëll Ir-Gen	Gjirokastrë	100		100	
14	TV Me kabëll Devi	Gramsh	100		100	
15	TV Me kabëll Multivizion	Kavajë	100		100	
16	TV Me kabëll Blu	Kavajë	100			100
17	TV Me kabëll Korca	Korçë	300		300	
18	TV Me kabëll Ju - AI	Krujë	100			100
19	TV Me kabëll Kucove	Kucovë	100		100	
20	TV Me kabëll Kukës	Kukës	100		100	
21	Tv Me kabëll Lissus	Lezhë	100		100	
22	TV Me kabëll Lezha	Lezhë	200	50	150	100
23	TV Me kabëll Lushnja	Lushnje	200		200	
24	TV Me kabëll Divjake	Lushnje	100	50	150	
25	TV Me kabëll Fokus	Maliq	100		100	
26	TV Me kabëll Mati	Mat	100		100	
27	TV Me kabëll APT	Memaliaj	300		300	
28	TV Me kabëll Memaliaj	Memaliaj	100		75	25
29	TV Me kabëll Mirdita	Mirditë	100		100	
30	TV Me kabëll KAM	Peqin	100		100	
31	TV Me kabëll Permet	Përmët	100		100	
32	TV me kabëll HB - CA	Peshkopi	100		100	
33	TV Me kabëll INKUSAT	Pogradec	100		100	
34	TV Me kabëll Delta	Pogradec	100	50		150
35	TV Me kabëll Prrenjas	Prrenjas	100	50	150	
36	TV Me kabëll Asparag	Rrogozhinë	100		100	
37	TV Me kabëll Butrinti	Sarandë				
38	TV Me kabëll Erzeni	Shijak	100		100	
39	TV Me kabëll Synej	Shijak	100			100
40	TV Me kabëll Danja	Shkoder	100	50	150	
41	TV Me kabëll Ani	Skrapar	100		100	
42	TV Me kabëll Polican	Skrapar	100		100	
43	TV Me kabëll Tepelena Sat	Tepelenë	100		100	
44	TV Me kabëll DCN	Tiranë	1000			1000
45	TV Me kabëll Star	Tiranë	1000		500	500
46	TV Me kabëll Alfa Tirane	Tiranë	1350			1350
47	TV Me kabëll Di - TV	Tiranë	1000			1000
48	TV Me kabëll Kamez	Tiranë	200	50		250
49	TV Me kabëll Ura Vajgurore	Ura Vajgurore	100		100	
50	TV Me kabëll Trio	Vlorë	350		350	
51	TV Me kabëll Orikum	Vlorë	100	50	150	
52	TV Me kabëll S3	Vore	100	50	150	
Shuma			11700	450	6675	5475
Realizimi në përqindje					54.94	

Informacion i datës 26.1.2009